

# STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 700 (I RISHIKUAR)

## FORMIMI I NJË OPINIONI DHE RAPORTIMI MBI PASQYRAT FINANCIARE

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date)

### PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
<b>Hyrje</b>	
Objekti i këtij SNA-je	1-4
Hyrja në Fuqi	5
Objektivat	6
Përkufizimet	7-9
<b>Kërkesat</b>	
Formimi i një Opinioni mbi Pasqyrat Financiare	10-15
Forma e Opinionit	16-19
Raporti i Audituesit	20-52
Informacioni Plotësues i Paraqitur së Bashku me Pasqyrat Financiare	53-54
<b>Zbatimi dhe Materiale të tjera Shpjeguese</b>	
Aspektet Cilësore të Praktikave të Kontabilitetit të Entitetit	A1-A3
Politikat Kontabël të Shpjeguara siç Duhet në Pasqyrat Financiare	A4
Informacioni i Paraqitur në Pasqyrat Financiare është i Përshtatshëm, i Besueshëm, i Krahasueshëm dhe i Kuptueshëm	A5
Shpjegimi i Efektit të Transaksioneve dhe Ngjarjeve Materiale mbi Informacionin e Përfshirë në Pasqyrat Financiare	A6
Vlerësimi nëse Pasqyrat Financiare janë Paraqitur Drejt	A7-A9
Përshkrimi i Kuadrit të Zbatueshëm të Raportimit Financiar	A10-A15
Forma e Opinionit	A16-A17
Raporti i Audituesit	A18-A77
Informacioni Plotësues i Paraqitur së bashku me Pasqyrat Financiare	A78-A84
Shtojcë: Ilustrime të Raporteve të Audituesit të Pavarur mbi Pasqyrat Financiare	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 700 (I rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*, duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*.

## Hyrje

### Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësinë e audituesit për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare. Ai, gjithashtu, merret me formulimin dhe përmbajtjen e raportit të audituesit që lëshohet në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare.
2. SNA 701<sup>1</sup> trajton përgjegjësinë e audituesit për të komunikuar çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit. SNA 705<sup>2</sup>(i rishikuar) dhe SNA 706<sup>3</sup>(i rishikuar) trajtojnë ndikimin në formën dhe në përmbajtjen e raportit të audituesit, kur audituesi në raportin e tij, shpreh një opinion të modifikuar ose përfshin një paragraf që thekson një Çështje apo një paragraf për Çështje të Tjera. SNA të tjera përmbajnë gjithashtu, kërkesa të raportimit që zbatohen kur lëshohet raporti i audituesit.
3. Ky SNA zbatohet për auditimin e një pakete të plotë të pasqyrave financiare të përgatitura për qëllime të përgjithshme dhe është shkruar në këtë kontekst. SNA 800<sup>4</sup> trajton vlerësimet e veçanta që bëhen në rastet kur pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta. SNA 805<sup>5</sup> trajton vlerësimet e veçanta që lidhen me një auditim të një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi, llogarie, apo zëri specifik të një pasqyre financiare. Ky SNA zbatohet gjithashtu, edhe në auditime për të cilat zbatohet SNA 800 ose SNA 805.
4. Kërkesat e këtij SNA-je synojnë të trajtojnë një ekuilibër të përshtatshëm ndërmjet nevojës për qëndrueshmëri dhe krahasueshmëri për audituesin që raporton në nivel global dhe nevojës për të rritur vlerën e raportimit të audituesit, duke e bërë informacionin që paraqitet në raportin e audituesit më të përshtatshëm për përdoruesit. Ky SNA ndihmon për të patur qëndrueshmëri në raportin e audituesit, por pranon gjithashtu, nevojën për fleksibilitet për t'ju përshtatur rrethanave të veçanta në juridiksione të caktuara. Qëndrueshmëria në raportin e audituesit, kur auditimi është kryer në përputhje me SNA-të, rrit besueshmërinë në tregun global duke i bërë shumë më lehtë të identifikueshme ato auditime që janë kryer në përputhje me standardet e njohura globalisht. Ajo, gjithashtu, ndihmon në rritjen e nivelit të të kuptuarit nga ana e përdoruesve dhe në identifikimin e rasteve të pazakonta kur ato ndodhin.

<sup>1</sup>SNA 701, *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

<sup>2</sup>SNA 705 (I rishikuar), *Modifikimet e Opinioneve në Raportin e Audituesit të Pavarur*

<sup>3</sup>SNA 706 (I rishikuar), *Paragrafët që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafët për Çështje të Tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur*

<sup>4</sup>SNA 800, *Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare të Përgatitura sipas Kuadrove për Qëllime Specifike*

<sup>5</sup>SNA 805, *Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare të Vetme, Elementëve dhe Llogarive ose Zërave të Veçantë të një Pasqyre Financiare*

## Hyrja në Fuqi

5. Ky SNA hyn në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që përfundojnë me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date.

## Objektivat

6. Objektivat e audituesit janë:
- (a) Të formojë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar mbi një vlerësim të konkluzioneve të nxjerra nga evidenca e auditimit e siguruar; dhe
  - (b) Të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti me shkrim.

## Përkufizimet

7. Për qëllimet e SNA-ve, termat në vijim kanë kuptimet e mëposhtme:
- (a) Pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme – Pasqyrat financiare të përgatitura sipas një kuadri për qëllime të përgjithshme.**
  - (b) Kuadri për qëllime të përgjithshme - Një kuadër i raportimit financiar që synon të plotësojë nevojat për informacion financiar të një numri të gjerë përdoruesish. Kuadri i raportimit financiar mund të jetë një kuadër i paraqitjes së drejtë ose një kuadër i pajtueshmërisë.**

**Termi “kuadër i paraqitjes së drejtë” përdoret për t`ju referuar një kuadri të raportimit financiar që kërkon pajtueshmërinë me kërkesat e kuadrit dhe:**

- (i) Pranon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, se për të arritur paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, mund të nevojitet që drejtimi të japë informacione shpjeguese përtej atyre që kërkohen në mënyrë të specifikuar nga kuadri; ose
- (ii) Pranon në mënyrë të drejtpërdrejtë, se mund të nevojitet që drejtimi të devijojë nga kërkesat e kuadrit për të arritur paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Këto devijime parashikohet të bëhen vetëm në raste ekstremisht të rralla.

Termi “kuadër i pajtueshmërisë” është përdorur për t`ju referuar një kuadri të raportimit financiar që kërkon pajtueshmërinë me kërkesat e kuadrit, por nuk përmban pohimet e dhëna në pikat (i) ose (ii) sa më sipër<sup>6</sup>.

---

<sup>6</sup>SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 13(a)

- (c) Opinion i pamodifikuar – Opinioni i shprehur nga audituesi kur ai arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.<sup>7</sup>
8. Referenca në këtë SNA për “pasqyrat financiare”, nënkupton “një paketë të plotë të pasqyrave financiare të përgatitura për qëllime të përgjithshme, përfshirë shënimet përkatëse<sup>8</sup>”. Shënimet përkatëse si rregull përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe informacione të tjera shpjeguese. Kërkesat e kuadrin të zbatueshëm të raportimit financiar përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare si edhe atë çfarë është një paketë e plotë e pasqyrave financiare.
9. Referenca në këtë SNA për “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar” nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe referenca për “Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik”, nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP-të) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik.

## Kërkesat

### Formimi i një Opinioni mbi Pasqyrat Financiare

10. Audituesi duhet të formojë një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.<sup>9,10</sup>
11. Në mënyrë që të formojë opinionin, audituesi duhet të arrijë në përfundimin nëse ai ka arritur sigurinë e arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare në tërësinë e tyre, nuk kanë anomali materiale, qoftë kjo për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Ky konkluzion duhet të ketë parasysh:
- (a) Konkluzionin e audituesit, në përputhje me SNA 330, nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit;<sup>11</sup>
- (b) Konkluzionin e audituesit, në përputhje me SNA 450, nëse anomali të e pakorrigjuara janë materiale, individualisht apo së bashku;<sup>12</sup> dhe

<sup>7</sup>Paragrafët 25-26 kanë të bëjnë me frazat e përdorura për të shprehur këtë opinion në rastin e një kuadri të paraqitjes së drejtë dhe respektivisht të një kuadri të pajtueshmërisë.

<sup>8</sup>SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 13(f) përcakton përmbajtjen e pasqyrave financiare.

<sup>9</sup>SNA 200, paragrafi 11

<sup>10</sup>Paragrafët 25-26 kanë të bëjnë me frazat e përdorura për të shprehur këtë opinion në rastin e një kuadri të paraqitjes së drejtë dhe respektivisht të një kuadri të pajtueshmërisë.

<sup>11</sup>SNA 330, *Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar*, paragrafi 26

<sup>12</sup>SNA 450, *Vlerësimi i Anomalive të Identifikuara gjatë Auditimit*, paragrafi 11

- (c) Vlerësimet e kërkuara nga paragrafët 12-15.
12. Audituesi do të vlerësojë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar. Ky vlerësim duhet të përfshijë marrjen në konsideratë të aspekteve cilësore të praktikave kontabël të entitetit, përfshirë edhe tregues të paragjykimeve të mundshme në gjykimet e drejtimit. (Ref: Para.A1-A3)
13. Në mënyrë të veçantë, audituesi do të vlerësojë, nëse në dritën e kërkesave të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar:
- (a) Pasqyrat financiare shpjegojnë në mënyrë të mjaftueshme politikat e rëndësishme kontabël të zgjedhura dhe të zbatuara. Kur bën këtë vlerësim, audituesi duhet të marrë në konsideratë përshtatshmërinë e politikave kontabël ndaj entitetit, dhe faktin nëse ato janë përgatitur në mënyrë të kuptueshme; (Ref: Para. A4)
- (b) Politikat kontabël të zgjedhura dhe të zbatuara janë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe janë të përshtatshme;
- (c) Çmuarjet kontabël të bëra nga drejtimi janë të arsyeshme;
- (d) Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare është i përshtatshëm, i besueshëm, i krahasueshëm dhe i kuptueshëm. Në bërjen e këtij vlerësimi audituesi duhet të marrë në konsideratë nëse:
- Informacioni që duhet të ishte përfshirë, është përfshirë, dhe nëse ky informacion është klasifikuar, grupuar apo ç`grupuar (detajuar) dhe etiketuar (karakterizuar) siç duhet.
  - Paraqitja e përgjithshme e pasqyrave financiare është kompromentuar me përfshirjen e informacionit që nuk është i përshtatshëm ose që nuk lejon një kuptueshmëri të saktë të çështjeve të paraqitura. (Ref: Para. A5)
- (e) Pasqyrat financiare japin informacione shpjeguese të mjaftueshme, të cilat bëjnë të mundur që përdoruesit e synuar të kuptojnë ndikimin e transaksioneve dhe të ngjarjeve materiale në informacionin e përcjellë në pasqyrat financiare; dhe (Ref: Para.A6)
- (f) Terminologjia e përdorur në pasqyrat financiare, përfshirë titullin e secilës pasqyrë financiare, është e përshtatshme.
14. Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, vlerësimi i kërkuar nga paragrafët 12-13 do të përfshijë gjithashtu, edhe faktin nëse pasqyrat financiare arrijnë një paraqitje të drejtë. Vlerësimi i audituesit

përsa i përket faktit nëse pasqyrat financiare arrijnë paraqitjen e drejtë duhet të përfshijë marrjen në konsideratë të:

- (a) Paraqitjes së përgjithshme, strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare; dhe
  - (b) Faktit nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet mbështetëse në një mënyrë të atillë që arrihet paraqitja e drejtë.
15. Audituesi duhet të vlerësojë nëse pasqyrat financiare në mënyrë të përshtatshme i referohen ose përshkruajnë kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. (Ref: Para.A10-A15)

### **Forma e Opinionit**

16. Audituesi do të shprehë një opinion të pamodifikuar kur ai arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

17. Nëse audituesi:

- (a) Arrin në përfundimin se, bazuar në evidencën e auditimit të siguar, pasqyrat financiare në tërësi, nuk janë pa anomali materiale; ose
- (b) Nuk është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi, nuk kanë anomali materiale,

audituesi do të modifikojë opinionin në raportin e tij në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).

18. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kërkesat e një kuadri të paraqitjes së drejtë nuk arrijnë një paraqitje të drejtë, audituesi duhet të diskutojë çështjen me drejtimin dhe në varësi nga kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar dhe të mënyrës se si çështja është zgjidhur, do të përcaktojë nëse duhet të modifikojë opinionin në raportin e tij në përputhje me SNA 705 (i rishikuar). (Ref: Para.A16)

19. Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të pajtueshmërisë, audituesi nuk ka nevojë të vlerësojë nëse pasqyrat financiare arrijnë paraqitjen e drejtë. Megjithatë, nëse në rrethana jashtëzakonisht të rralla, audituesi arrin në përfundimin se keto pasqyra financiare janë çorientuese, audituesi duhet të diskutojë çështjen me drejtimin dhe, në varësi se si ajo zgjidhet, duhet të përcaktojë nëse dhe si do ta komunikojë atë në raportin e audituesit. (Ref: Para.A17)

## Raporti i Audituesit

20. Raporti i audituesit duhet të jetë në formë të shkruar. (Ref: Para.A18-A19)

*Raporti i Audituesit për Auditimet e Kryera në Përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.*

Titulli

21. Raporti i audituesit duhet të ketë një titull, i cili në mënyrë të qartë tregon që raporti është i një audituesi të pavarur. (Ref: Para.A20)

Marrësi

22. Raporti i audituesit duhet të adresohet, siç kërkohet, bazuar në rrethanat e angazhimit. (Ref: Para.A21)

Opinion i Audituesit

23. Seksioni i parë i raportit të audituesit duhet të përfshijë opinionin e audituesit dhe do të ketë titullin “Opinion”.

24. Seksioni i Opinionit në raportin e audituesit, gjithashtu do të:

- (a) Identifikojë entitetin, pasqyrat financiare të të cilit janë audituar;
- (b) Deklarojë që pasqyrat financiare janë audituar;
- (c) Identifikojë titullin e secilës pasqyrë, që përfshihet në pasqyrat financiare;
- (d) Referohet tek shënimet shpjeguese, përfshirë përmbledhjen e politikave kontabël më të rëndësishme; dhe
- (e) Specifikojë datën ose periudhën e mbuluar nga secila pasqyrë financiare që përfshihet në pasqyrat financiare. (Ref: Para. A22-A23)

25. Kur shpreh një opinion pa rezervë mbi pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, opinionin e audituesit, përveç rasteve nëse kërkohet ndryshe me ligj ose rregullore, duhet të përdorë një nga shprehjet e mëposhtme, të cilat konsiderohen të barazvlefshme:

- (a) Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, ... në përputhje me [kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar]; ose

- (b) Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të ... në përputhje me [kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar]. (Ref: Para. A24-A31)
26. Kur shpreh një opinion pa rezervë mbi pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër të pajtueshmërisë, opinionin e audituesit do të jetë që pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me [kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar]. (Ref: Para. A26-A31)
27. Nëse referenca në kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar në opinionin e audituesit nuk janë SNRF-të të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ose SNKSP-të të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, opinionin e audituesit duhet të identifikojë juridiksionin e origjinës së kuadrit.

#### Baza për Opinionin

28. Raporti i audituesit duhet të përfshijë një seksion, që vijon direkt pas seksionit të Opinionit, me titullin “Baza për Opinionin”, që: (Ref: Para. A32)
- (a) Të shprehë se auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit; (Ref: Para. A33)
- (b) T’i referohet seksionit të raportit të audituesit, i cili përshkruan përgjegjësitë e audituesit sipas SNA-ve;
- (c) Të përfshijë një deklaratë se audituesi është i pavarur nga entiteti në pajtim me kërkesat etike përkatëse që kanë të bëjnë me auditimin, dhe se ai ka përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në pajtim me këto kërkesa. Deklarata duhet të identifikojë juridiksionin e origjinës së kërkesave përkatëse etike ose duhet t’i referohet *Kodit të Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK); dhe (Ref: Para. A34-A39)
- (d) Të shprehë nëse audituesi beson se evidenca e auditimit e marrë nga ai, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të shërbyer si një bazë për opinionin e audituesit.

#### Vijimësia

29. Kur është e zbatueshme, audituesi duhet të raportojë në pajtim me SNA 570 (i rishikuar).<sup>13</sup>

<sup>13</sup>SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*, paragrafët 21-23



Çështjet Kryesore të Auditimit

30. Për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara, audituesi duhet të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit në përputhje me SNA 701.
31. Kur audituesi kërkohet nga ligji ose rregullat ose kur vendos të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit, ai duhet ta bëjë këtë gjë në pajtim me SNA 701. (Ref: Para. A40-A42)

Informacioni tjetër

32. Kur është e zbatueshme, audituesi duhet të raportojë në pajtim me SNA 720 (i rishikuar).

Përgjegjësitë për Pasqyrat Financiare

33. Raporti i audituesit do të përfshijë një seksion me titull “Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare”. Audituesi do të përdorë termin që është i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar dhe nuk është nevoja t'i referohet në mënyrë specifike “drejtimit”. Në disa juridiksione, referenca e përshtatshme mund të jetë për personat e ngarkuar me qeverisjen (Ref: Para. A44).
34. Ky seksion i raportit të audituesit duhet të përshkruajë përgjegjësinë e drejtimit për: (Ref: A45-A48)
- (a) Përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe për vendosjen e zbatimitin e atyre kontrolleve të brendshme, që ai i konsideron të nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit.
  - (b) Vlerësimin e aftësisë së entitetit për të vijuar veprimtarinë<sup>14</sup> dhe nëse përdorimi i bazës kontabël të vijimësisë është i përshtatshëm, si dhe në dhënien e informacioneve, kur një gjë e tillë është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë. Shpjegimi i përgjegjësisë së drejtimit për këtë vlerësim do të përfshijë një përshkrim që tregon se kur është i përshtatshëm përdorimi i bazës kontabël të vijimësisë (Ref: Para. A48).
35. Ky seksion i raportit të audituesit do të identifikojë gjithashtu, personat që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar, kur ata që janë përgjegjës për një mbikëqyrje të tillë, janë të ndryshëm nga ata që përmbushin përgjegjësitë e përshkruara në paragrafin 34 më sipër. Në këtë rast, titulli i këtij seksioni duhet t'i referohet gjithashtu “Personave të Ngarkuar me Qeverisjen” ose termit që është i përshtatshëm në juridiksionin përkatës (Ref: Para. A49).

---

<sup>14</sup>SNA 570 (I rishikuar), paragrafi 2

36. Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, përshkrimi i përgjegjësive për pasqyrat financiare në raportin e audituesit do t'i referohet “përgatitjes dhe paraqitjes së drejtë të këtyre pasqyrave financiare” ose “përgatitjes së pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë”, cilado qoftë më e përshtatshme sipas rrethanave.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

37. Raporti i audituesit do të përfshijë një seksion me titull “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”.

38. Ky seksion i raportit të audituesit do të:

(a) deklarojë që objektivat e audituesit janë:

- i. Të arrijë siguri të arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi, janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; dhe
- ii. Të lëshojë një raport audituesi që përfshin opinionin e audituesit (Ref: Para. A51)

(b) deklarojë që siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garanci që një auditim i kryer në pajtim me SNA-të do të zbulojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston; dhe

(c) deklarojë që anomali të mund të ndodhin nga mashtrimi ose gabimi, si dhe:

- i. Të përshkruajë që ato janë konsideruar materiale, individualisht ose së bashku, nëse pritet që ato të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare; ose<sup>15</sup>
- ii. Të japë një përkufizim ose përshkrim të materialitetit në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

39. Me tej, seksioni i Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare në raportin e audituesit do të: (Ref: Para. A50)

(a) deklarojë se, si pjesë e një e auditimi në pajtim me SNA-të, audituesi ushtron gjykimin profesional dhe mban skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit; dhe

(b) përshkruajë një auditim duke deklaruar se përgjegjësitë e audituesit janë:

<sup>15</sup>SNA 320, *Materialiteti në Planifikimin dhe në Kryerjen e një Auditimi*, paragrafi 2

- (i) Të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; të hartojë dhe kryejë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve; dhe, të marrë evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin e audituesit. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- (ii) Të sigurojë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit. Në rrethanat kur audituesi ka edhe përgjegjësinë për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, audituesi do të heqë frazën ku theksohet se marrja në konsideratë e kontrollit të brendshëm nga audituesi nuk ka si qëllim shprehjen e një opinioni mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm
- (iii) Të vlerësojë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.
- (iv) Të arrijë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, të vlerësojë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrehana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Nëse audituesi arrin në konkluzionin se ekziston një pasiguri materiale, ai është i detyruar të tërheqë vëmendjen në raportin e audituesit, lidhur me informacionet shpjeguese përkatëse të dhëna në pasyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojë opinionin. Konkluzionet e audituesit bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrehana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.
- (v) Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, të vlerësojë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet mbështetëse në një mënyrë të atillë që arrihet paraqitja e drejtë.

(c) Në rastet kur zbatohet SNA 600<sup>16</sup>, do të përshkruajë më tej përgjegjësitë e audituesit në një angazhim auditimi të grupit duke deklaruar se:

- (i) Përgjegjësitë e audituesit janë që të sigurojë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në lidhje me informacionin financiar të entiteteve ose aktiviteteve të biznesit brenda grupit, për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të grupit.
- (ii) Audituesi është përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe performancën e auditimit të grupit; dhe
- (iii) Audituesi mbetet përgjegjësi i vetëm për opinionin e audituesit.

40. Seksioni i i Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare gjithashtu do të: (Ref: Para. A50)

- (a) Deklarojë se audituesi komunikon me personat e ngarkuar me qeverisjen, midis të tjerash, lidhur me objektin e planifikuar dhe kohën (afatet) e auditimit dhe për gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që audituesi e identifikon gjatë auditimit;
- (b) Për auditimet e pasqyrave financiare të entiteteve të listuara, të deklarojë që audituesi i ka dhënë personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë ku thuhet që audituesi ka zbatuar kërkesat etike përkatëse lidhur me pavarësinë dhe u ka komunikuar atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështje të tjera, që mendohet se në mënyrë të arsyeshme mund të kenë ndikim në pavarësinë e audituesit, dhe aty ku është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse; dhe
- (c) Për auditimet e pasqyrave financiare të entiteteve të listuara dhe entiteteve të tjera për të cilat do të komunikohen çështjet kryesore të auditimit në përputhje me SNA 701, të deklarojë se nga çështjet e komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, audituesi përcakton ato çështje që kanë qenë më të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe që për këto arsye janë çështjet kryesore të auditimit. Audituesi i përshkruan këto çështje në raportin e audituesit me përjashtim të rastit kur ligji ose rregullat ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, audituesi vendos që çështja të mos komunikohet në raportin e audituesit, pasi pasojat negative të komunikimit, pritet në mënyrë të konsiderueshme të tejkalojnë përfitimet që ka interesi publik nga ky komunikim. (Ref: Para. A53)

<sup>16</sup>SNA 600, *Konsiderata të Veçanta – Auditimi i Pasqyrave Financiare të Grupit (Duke Përfshirë Punën e Audituesit të Entitetit të Kontrolluar)*

Vendndodhja e përshkrimit të përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

41. Përshkrimi i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare siç kërkohet nga paragrafët 39-40 do të përfshihet: (Ref: Para. A54)
- (a) Brenda trupit të raportit të audituesit;
  - (b) Brenda një shtojce të raportit të audituesit, rast në të cilin raporti i audituesit duhet të përfshijë një referencë të vendndodhjes së shtojcës; ose (Ref: Para. A54-A55)
  - (c) Me një reference specifike brenda raportit të audituesit për vendndodhjen e një përshkrimi të tillë në faqen e web-it të autoritetit të përshtatshëm, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit në mënyrë të shprehur qarte lejojnë që audituesi të veprojë në këtë mënyrë. (Ref: Para. A54, A56-A57)
42. Kur audituesi i referohet një përshkrimi të përgjegjësive të audituesit të dhëna në një faqe interneti të një autoriteti të përshtatshëm, audituesi duhet të përcaktojë se një përshkrim i tillë trajton, dhe nuk është në kundërshtim me kërkesat në paragrafët 39-40 të këtij SNA-je. (Ref: Para. A56)

#### Përgjegjësi të Tjera të Raportimit

43. Nëse audituesi trajton përgjegjësitë e tjera të raportimit në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare, të cilat janë përgjegjësi shtesë, përveç përgjegjësive të audituesit sipas SNA-ve, këto përgjegjësi të tjera të raportimit do të trajtohen në një seksion të veçantë në raportin e audituesit, që titullohet “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore” apo përndryshe, në përshtatje me përmbajtjen e seksionit, përveç nëse kur këto përgjegjësi të tjera raportimi trajtojnë të njëjtat çështje si ato të paraqitura në përgjegjësitë e raportimit që kërkohen nga SNA-të, rast në të cilin përgjegjësitë e tjera të raportimit mund të paraqiten në të njëjtin seksion me atë të elementeve të raportimit përkatës të kërkuar nga SNA-të. (Ref: Para. A58-A60)
44. Nëse përgjegjësitë e tjera të raportimit paraqiten në të njëjtin seksion me elementët përkatës të raportimit të kërkuar nga SNA-të, raporti i audituesit duhet të diferencojë në mënyrë të qartë përgjegjësitë e tjera të raportimit nga ato të kërkuara nga SNA-të. (Ref: Para. A60)
45. Nëse raporti i audituesit përmban një seksion të veçantë që trajton përgjegjësitë e tjera të raportimit, kërkesat në paragrafet 21-40 të këtij SNA-je duhet të përfshihen nën një seksion me titull “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare”. “Raporti mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore” do të ndjekë “Raportin mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare”. (Ref: Para. A60)

Emri i ortakut të Angazhimit

46. Emri i ortakut të angazhimit do të përfshihet në raportin e audituesit për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara, me përjashtim kur, në raste të rralla, përfshirja e emrit pritet në mënyrë të arsyeshme të çojë në një kërcënim të konsiderueshëm të sigurisë personale. Në rastet e rralla, kur audituesi parashikon të mos e përfshijë emrin e ortakut të angazhimit në raportin e auditimit, audituesi duhet ta diskutojë këtë fakt me personat e ngarkuar me qeverisjen, për t'i informuar ata për vlerësimin që audituesi ka bërë për mundësinë dhe seriozitetin e një kërcënimi të konsiderueshëm të sigurisë personale.

Nënshkrimi i Audituesit

47. Raporti i audituesit do të jete i nënshkruar (firmosur). (Ref: Para.A64-A5)

Adresa e Audituesit

48. Raporti do të japë vendndodhjen në shtetin apo juridiksionin ku audituesi ushtron profesionin e tij.

Data e Raportit të Audituesit

49. Audituesi do të datojë raportin mbi pasqyrat financiare jo më herët se data në të cilën audituesi ka marrë evidencën e mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbi bazën e së cilës është shprehur opinioni mbi pasqyrat financiare, përfshirë edhe evidencën që tregon se: (Ref: Para. A66-A41)

- (a) Janë përgatitur të gjitha pasqyrat që përbëjnë paketën e pasqyrave financiare, përfshirë shënimet shpjeguese përkatëse; dhe
- (b) Personat që kanë autoritetin e njohur kanë pohuar se kanë marrë përgjegjësinë për këto pasqyra financiare.

*Raporti i Audituesit i Përshkruar nga Ligji apo Rregullat*

50. Nëse audituesit i kërkohet sipas ligjit apo rregullave të një juridiksioni të veçantë, që të përdorë një paraqitje apo formulim të veçantë të raportit të audituesit, ky raport do t'i referohet Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit vetëm nëse raporti i audituesit përfshin, të paktën, secilin nga elementët e mëposhtëm: (Ref: Para. A70-A71)

- (a) Një titull.
- (b) Një adresë, siç kërkohet nga rrethanat e angazhimit.

- (c) Një seksion të Opinioneve, që përmban një shprehje të opinionit mbi pasqyrat financiare dhe një referencë për kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar të përdorur për të përgatitur pasqyrat financiare (përfshirë identifikimin e juridiksionit të origjinës së kuadrit të raportimit financiar, që nuk janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ose Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, shiko paragrafin 27).
- (d) Një identifikim të pasqyrave financiare që janë audituar.
- (e) Një deklaratë që audituesi është i pavarur nga entiteti në përputhje me kërkesat etike përkatëse që kanë të bëjnë me auditimin, dhe që ka përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Deklarata duhet të identifikojë juridiksionin e origjinës së kërkesave etike përkatëse ose duhet t'i referohet Kodit të BSNEPK.
- (f) Kur është e zbatueshme, një seksion që trajton, dhe që nuk është në kundërshtim me kërkesat raportuese të dhëna në paragrafin 22 të SNA 570 (i rishikuar).
- (g) Kur është e zbatueshme, një seksion për Bazën për Opinioneve me Rezervë (ose Kundër) që trajton dhe që nuk është në kundërshtim me kërkesat raportuese të dhëna në paragrafin 23 të SNA 570 (i rishikuar).
- (h) Kur është e zbatueshme, një seksion që përfshin informacionin e kërkuar nga SNA 701, ose informacion shtesë lidhur me auditimin që kërkohet nga ligji ose rregullat dhe që trajton, e që nuk është në kundërshtim me kërkesat raportuese të këtij SNA-je.<sup>17</sup> (Ref: Para. A72-A75)
- (i) Kur është e zbatueshme, një seksion që trajton kërkesat raportuese të dhëna në paragrafin 24 të SNA 720 (i rishikuar).
- (j) Një përshkrim të përgjegjësive të drejtimit për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe një identifikim të personave përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar që trajton, dhe që nuk është në kundërshtim me, kërkesat raportuese në paragrafët 33-36.
- (k) Një referencë ndaj Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe ligjit ose rregullave, dhe një përshkrim të përgjegjësive të audituesit për një auditim të pasqyrave financiare që trajton, dhe që nuk është në kundërshtim me, kërkesat raportuese në paragrafët 37-40. (Ref: Para. A50-A53)
- (l) Për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara, emrin e ortakut të angazhimit, përveç

---

<sup>17</sup>SNA 701, paragrafët 11-16

nëse, kur në raste të rralla, një informacion i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të çojë në një kërcënim të konsiderueshëm të sigurisë personale.

- (m) Nënshkrimin e audituesit.
- (n) Adresën e audituesit.
- (o) Datën e raportit të audituesit.

*Raporti i Audituesit për Auditimet e Kryera në Përputhje si me Standardet e Auditimit të një Juridiksioni të Caktuar ashtu edhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*

51. Një audituesi mund t'i kërkohe të kryejë një auditim në përputhje me standardet e auditimit të një juridiksioni të veçantë("standardet kombëtare të auditimit"), por përveç kësaj, mund t'i kërkohe të veprojë edhe në pajtueshmëri me SNA-të, në kryerjen e auditimit. Në një rast të tillë, raporti i audituesit, përveç standardeve kombëtare të auditimit, mund t'i referohet Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, por audituesi duhet ta bëjë këtë vetëm në rast se: (Ref: Para. A76-A77)
- (a) Nuk ka konflikt mes kërkesave në standardet kombëtare të auditimit dhe atyre në SNA-të që mund ta çojnë audituesin (i) në formimin e një opinionit të ndryshëm, ose (ii) të mos përfshijë një paragraf që Thekson Çështjen ose një paragraf për Çështje të Tjera, që në rrethana të veçanta, kërkohe nga SNA-të; dhe
  - (b) Raporti i audituesit përmban, të paktën secilin element të vendosur në paragrafin 50(a)-(o) kur audituesi përdor paraqitjen ose formulimin e specifikuar nga standardet kombëtare të auditimit. Megjithatë, referenca tek "ligji ose rregullat" në paragrafin 50(k) do të lexohet si referencë me standardet kombëtare të auditimit. Raporti i audituesit, në këtë mënyrë, duhet të identifikojë këto standarde kombëtare të auditimit.
52. Kur raporti i audituesit i referohet si standardeve kombëtare të auditimit ashtu dhe atyre ndërkombëtare, raporti i audituesit duhet të identifikojë juridiksionin e origjinës së standardeve kombëtare të auditimit.

**Informacioni Plotësues i Paraqitur së Bashku me Pasqyrat Financiare** (Ref: Para. A78-A84)

53. Nëse informacioni plotësues, që nuk është kërkuar nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar, është paraqitur së bashku me pasqyrat financiare të audituara, audituesi do të vlerësojë nëse, sipas gjykimit të tij profesional, ky informacion plotësues është sidoqoftë një pjesë përbërëse e pasqyrave financiare për shkak të natyrës ose mënyrës se si është paraqitur. Kur ai është një pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, informacioni plotësues do të mbulohet nga opinionit i audituesit.



54. Nëse informacioni plotësues, që nuk është kërkuar nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar, nuk konsiderohet pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara, audituesi duhet të vlerësojë nëse ky informacion plotësues është paraqitur në një mënyrë që e diferencon qartë atë nga pasqyrat financiare të audituara. Nëse ky nuk është rasti, audituesi duhet t'i kërkojë drejtimit të ndryshojë mënyrën se si informacioni shtesë i paudituar është paraqitur. Në qoftë se drejtimi refuzon ta bëjë këtë, audituesi do të shpjegojë në raportin e auditimit faktin që ky informacion plotësues nuk është audituar.

\*\*\*

## Zbatimi dhe Materiale të tjera Shpjeguese

### Aspektet Cilësore të Praktikave të Kontabilitetit të Entitetit (Ref: Para. 12)

A1. Drejtimi kryen një numër gjykimesh rreth shumave dhe informacionit të dhënë në pasqyrat financiare.

A2. SNA 260 (i rishikuar) përmban një diskutim të aspekteve cilësore të praktikave të kontabilitetit<sup>18</sup>. Në marrjen në konsideratë të aspekteve cilësore të praktikave të kontabilitetit të entitetit, audituesi mund të informohet rreth paragjytimeve të mundshme në gjykimet e drejtimit. Audituesi mund të arrijë në përfundimin se efekti kumulativ i mungesës së neutralitetit, së bashku me efektin e anomalive të pakorrigjuara, bën që pasqyrat financiare në tërësi të jenë keq-paraqitur materialisht. Treguesit e mungesës së neutralitetit, që mund të ndikojnë në vlerësimin e audituesit për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi janë keq-paraqitur materialisht përfshijnë sa më poshtë:

- Korrigjimin me zgjedhje të anomalive të sjella në vëmendjen e drejtimit gjatë auditimit (për shembull, korrigjimin e anomalive me efekt në rritjen e të ardhurave të raportuara, por jo korrigjimin e anomalive që kanë efekt në uljen e të ardhurave të raportuara).
- Paragjytime të mundshme të drejtimit në bërjen e çmuarjeve kontabël.

A3. SNA 540 trajton paragjykimet e mundshme të drejtimit kur ai bën çmuarje kontabël<sup>19</sup>. Treguesit e paragjytimeve të mundshme të drejtimit nuk përbëjnë anomali për qëllime të nxjerrjes së konkluzioneve mbi arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të veçanta. Sidoqoftë, ato mund të ndikojnë në vlerësimin e audituesit nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale.

<sup>18</sup>SNA 260 (I rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, Shtojca 2

<sup>19</sup>SNA 540, *Auditimi i Çmuarjeve Kontabël, Përfshirë Çmuarjet Kontabël të Vlerës së Drejtë, si dhe Shpjegimet Përkatese*, paragrafi 21

**Politikat Kontabël të Shpjeguara siç Duhet në Pasqyrat financiare (Ref: Para. 13(a))**

A4. Për të vlerësuar nëse pasqyrat financiare shpjegojnë siç duhet politikat kontabël të rëndësishme të përzgjedhura dhe të zbatuara, audituesi do të marrë në konsideratë çështje të tilla si:

- Nëse janë dhënë të gjitha informacionet shpjeguese lidhur me politikat kontabël të rëndësishme që kërkohet të përfshihen sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar;
- Nëse informacioni i dhënë për politikat kontabël të rëndësishme është i përshtatshëm dhe si pasojë, reflekton sesi kriteret e njohjes, matjes dhe paraqitjes në kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, janë zbatuar në klasat e transaksioneve, tepricat e llogarive dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare sipas rrethanave të veçanta të aktiviteteve të entitetit dhe të mjedisit të tij; dhe
- Qartësia me të cilën janë paraqitur politikat kontabël të rëndësishme.

**Informacioni i Paraqitur në Pasqyrat Financiare është i Përshtatshëm, i Besueshëm, i Krahasueshëm dhe i Kuptueshëm (Ref. Para. 13(d))**

A5. Vlerësimi i kuptueshmërisë së pasqyrave financiare përshin marrjen në konsideratë të çështjeve të tilla si, nëse:

- Informacioni në pasqyrat financiare është paraqitur në mënyrë të qartë dhe të përmbledhur.
- Vendosija e informacioneve shpjeguese të rëndësishme ju jep atyre rëndësinë e duhur (për shembull, kur perceptohet vlerë për përdoruesit lidhur me njëinformacion specifik për entitetin), dhe nëse shpjegimet janë lidhur me referenca në një mënyrë të tillë që, për përdoruesit, nuk përbën një sfidë gjetja e informacionit të nevojshëm.

**Shpjegimi i Efektit të Transaksioneve dhe Ngjarjeve Materiale mbi Informacionin e Përfshirë në Pasqyrat Financiare (Ref: Para. 13 (e))**

A6. Është e zakonshme që pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër për qëllime të përgjithshme të paraqesin pozicionin financiar të një entiteti, performancën financiare dhe flukset e parasë (mjeteve monetare). Vlerësimi nëse pasqyrat financiare, duke patur parasysh kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, japin shpjegime të mjaftueshme për t'ju bërë të mundur përdoruesve të synuar të kuptojnë efektin e transaksioneve dhe ngjarjeve materiale mbi pozicionin financiar të entitetit, performancën financiare dhe

flukset e mjeteve monetare, përfshin marrjen në konsideratë të çështjeve të tilla, si:

- Masën në të cilën informacioni në pasqyrat financiare është i përshtatshëm dhe i lidhur me rrethanat e entitetit; dhe
- Nëse shpejgimet e dhëna janë të përshtatshme për të ndihmuar përdoruesit e synuar që të kuptojnë:
  - o Natyrën dhe masën e aktiveve dhe detyrimeve të mundshme të entitetit, që rrjedhin nga transaksione ose ngjarje që nuk përmbushin kriterin e njohjes (ose kriterin për mosnjohje) të përcaktuar nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar.
  - o Natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve të anomalisë materiale që lindin nga transaksionet dhe ngjarjet.
  - o Metodat e përdorura dhe supozimet e gjykimet e bëra, si dhe ndryshimet në to, që ndikojnë shumat e paraqitura, ose përndryshe të shpjeguara, përfshirë analiza ndjeshmërie të përshtatshme.

### **Vlerësimi Nëse Pasqyrat Financiare Janë Paraqitur Drejtë**

A7. Disa kuadro të raportimit financiar njohin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar konceptin e paraqitjes së drejtë.<sup>20</sup> Siç theksohet në paragrafin 7(b) të këtij SNA-je, një kuadër i paraqitjes së drejtë<sup>21</sup> jo vetëm kërkon pajtueshmëri me kërkesat e kuadrit, por gjithashtu pranon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar që mund të jetë e nevojshme që drejtimi të japë shpjegime përtej atyre të kërkuara specifikisht nga kuadri.<sup>22</sup>

A8. Vlerësimi i audituesit lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare janë paraqitur drejtë, si në aspektin e paraqitjes ashtu dhe atë të dhënies së shpjegimeve, është çështje e gjykimit profesional. Ky vlerësim merr në konsideratë çështje të tilla si faktet dhe rrethanat e entitetit, përfshirë ndryshimet në to, bazuar në njohjen që audituesi ka për entitetin dhe evidencën e auditimit të siguruar gjatë auditimit. Vlerësimi përfshin gjithashtu marrjen parasysht për shembull të shpjegimeve që duhen dhënë për paraqitjen e drejtë që lindin nga çështje që mund të jenë materiale (për shembull, anomali të konsiderohen të jenë materiale nëse ato pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të

<sup>20</sup>Për shembull, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) theksojnë që paraqitja e drejtë kërkon paraqitjen me bsueshmëri të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriterin e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.

<sup>21</sup>Shiko SNA 200, paragrafi 13(a)

<sup>22</sup>Për shembull, SNRF-të kërkojnë që entiteti të japë shpjegime shtesë kur pajtueshmëria me kërkesa të caktuara të SNRF-ve është e pamjaftueshme për të bërë të mundur që përdoruesit e synuar të kuptojnë ndikimin e transaksioneve të caktuara në pozicionin financiar dhe performancën financiare të entitetit (Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*, paragrafi 17(c)).

bëra bazuar në pasqyrat financiare si një e tërë), siç është efekti i zhvillimit të kërkesave të raportimit financiar ose mjedisit ekonomik në ndryshim.

A9. Vlerësimi nëse pasqyrat financiare janë paraqitur drejtë mund të përfshijë, për shembull, diskutimin me drejtimin dhe personat e ngritur me qeverisjen lidhur me pikëpamjen e tyre mbi arësyen përse një paraqitje e caktuar është zgjedhur, si dhe alternativat e tjera që mund të ishin marrë në konsideratë. Diskutimi mund të përfshijë, për shembull:

- Nivelin në të cilin shumat në pasqyrat financiare janë përmbledhur ose zbërthyer, dhe nëse paraqitja e shumëve ose shpjegimeve fsheh informacionin e rëndësishëm, ose rezultojnë në informacion çorientues.
- Koherenca me praktikën e përshtatshme të industrisë, ose nëse pikënisje të caktuara janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit dhe për pasojë të justifikuara.

#### **Përshkrimi i Kuadrit të Zbatueshëm të Raportimit Financiar (Ref: Para. 15)**

A10. Siç shpjegohet në SNA 200, përgatitja e pasqyrave financiare nga drejtimi dhe, kur është e përshtatshme, nga personat e ngarkuar me qeverisjen, kërkon përfshirjen e një përshkrimi të duhur të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar në pasqyrat financiare<sup>23</sup>. Ky përshkrim i këshillon përdoruesit e pasqyrave financiare për kuadrin mbi të cilin janë bazuar pasqyrat financiare.

A11. Një përshkrim që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të zbatueshëm të raportimit financiar të veçantë është i përshtatshëm vetëm nëse pasqyrat financiare janë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e atij kuadri, të cilat janë në fuqi gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare.

A12. Një përshkrim i kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar që përmban gjuhë të kufizuar ose të pasaktë (për shembull, “pasqyrat financiare janë në pajtueshmëri thelbësore me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”) nuk është një përshkrim i përshtatshëm i atij kuadri, pasi ai mund të çorientojë përdoruesit e pasqyrave financiare.

#### *Referimi në më shumë se një Kuadër të Raportimit Financiar*

A13. Në disa raste, pasqyrat financiare mund të deklarojnë ato janë përgatitur në përputhje me dy kuadro të raportimit financiar (për shembull, kuadri kombëtar dhe SNRF-të). Kjo mund të jetë për shkak se drejtimi i është kërkuar ose ka zgjedhur, të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me të dy kuadrot, rast në të cilin të dy janë kuadro të zbatueshëm të raportimit financiar. Një përshkrim i tillë është i përshtatshëm vetëm nëse pasqyrat financiare janë në pajtueshmëri me

<sup>23</sup>SNA 200, paragrafët A2-A3

secilin prej kuadrove individualisht. Që të konsiderohen të përgatitura në përputhje me të dy kuadrot, pasqyrat financiare duhet të pajtohen me të dy kuadrot njëherësh dhe pa qenë nevoja për rakordimin e pasqyrave. Në praktikë, pajtimi i njëhershëm nuk ka të ngjarë të ndodhë, përveç nëse juridiksioni ka adoptuar kuadrin tjetër (për shembull, SNRF-të) si kuadër të tij të vetin kombëtar, apo ka eliminuar të gjitha pengesat për t'u pajtuar me të.

- A14. Pasqyrat financiare që janë përgatitur në përputhje me një kuadër të raportimit financiar dhe që përmbajnë një shënim apo një pasqyrë plotësuese që rakordon rezultatet me ato që do të ishin treguar sipas një kuadri tjetër, nuk janë përgatitur në përputhje me atë kuadër tjetër. Kjo, pasi pasqyrat financiare nuk përfshijnë të gjithë informacionin në mënyrën e kërkuar nga kuadri tjetër.
- A15. Megjithatë, pasqyrat financiare mund të jenë përgatitur në përputhje me një kuadër të zbatueshëm të raportimit financiar dhe, veç kësaj, shënimet e pasqyrave përshkruajnë nivelin në të cilin pasqyrat financiare pajtohen me kuadrin tjetër (për shembull, pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kuadrin kombëtar, që gjithashtu, përshkruajnë nivelin në të cilin ato pajtohen me SNRF-të). Një përshkrim i tillë është informacion financiar plotësues dhe, siç trajtohet në paragrafin 47, konsiderohet një pjesë përbërëse e pasqyrave financiare dhe, prandaj, mbulohet nga opinioni i audituesit.

### **Forma e Opinionit**

- A16. Mund të ketë raste kur pasqyrat financiare, ndonëse të përgatitura në përputhje me kërkesat e një kuadri të paraqitjes së drejtë, nuk arrijnë paraqitjen e drejtë. Nëse ky është rasti, atëherë drejtimi mund të përfshijë informacion shtesë në pasqyrat financiare përveç atyre të kërkuara specifikisht nga kuadri, ose në rrethana jashtëzakonisht të rralla, të devijojë nga një kërkesë në kuadër, në mënyrë që të arrijë një paraqitje të drejtë të pasqyrave financiare (Ref: Para. 18).
- A17. Do të jetë jashtëzakonisht e rrallë për audituesin të konsiderojë çorientuese pasqyrat financiare, që janë përgatitur në përputhje me një kuadër të pajtueshmërisë, nëse në përputhje me SNA 210, audituesi ka përcaktuar që kuadri është i pranueshëm.<sup>24</sup> (Ref: Para. 19)

### **Raporti i Audituesit (Ref: Para. 20)**

- A18. Një raport me shkrim përmbledh raportet e lëshuara në format të printuar në letër dhe ato që përdorin një mjet elektronik.
- A19. Shtojca në këtë SNA, përmban ilustrime të raporteve të audituesve mbi pasqyrat financiare, që përfshijnë elementët e përcaktuar në paragrafët 21-49. Me

<sup>24</sup>SNA 210, *Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit*, paragrafi 6(a)

përfshirje të seksioneve të Opinionit dhe Bazës për Opinionin, ky SNA nuk vendos kërkesa lidhur me renditjen e elementëve të raportit të audituesit. Megjithatë, ky SNA kërkon përdorimin e titujve të caktuar, të cilët synojnë të ndihmojnë për të bërë më të dallueshme raportet e audituesit të cilat i referohen auditimeve të kryera në pajtim me SNA-të, veçanërisht në situatat kur elementët e raportit të audituesit janë paraqitur në një renditje që ndryshon nga raportet e audituesit të dhëna si ilustrim në Shtojcën e këtij SNA-je.

*Raporti i Audituesit për Auditimet e Kryera në Përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*

Titulli (Ref: Para. 21)

A20. Një titull që tregon se raporti është i një audituesi të pavarur, për shembull, “Raporti i Audituesit të Pavarur”, dallon raportin e audituesit të pavarur nga raportet e lëshuara nga të tjerët.

Marrësi (Ref. Para. 22)

A21. Ligji, rregullat ose kushtet e angazhimit mund të specifikojnë se kujt duhet t’i adresohet raporti i audituesit, në atë juridiksion të caktuar. Raporti i audituesit, normalisht, i adresohet atyre për të cilët raporti është përgatitur, shpesh aksionarëve ose personave të ngarkuar me qeverisjen e entitetit, pasqyrat financiare të të cilit janë audituar.

Opinionin i Audituesit (Ref: Para. 24-26)

Referencë ndaj pasqyrave financiare që janë audituar

A22. Raporti i audituesit deklaron, për shembull, se audituesi ka audituar pasqyrat financiare të entitetit, të cilat përfshijnë [vendoset titulli i secilës prej pasqyrave financiare që përfshihet në paketën e plotë të pasqyrave financiare të kërkuara nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar, duke specifikuar datën ose periudhën e mbuluar nga secila pasqyrë financiare] dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, përfshirë një përmbledhjetë politikave kontabël më të rëndësishme.

A23. Kur audituesi është në dijeni të faktit se pasqyrat financiare të audituara do të përfshihen në një dokument që përmban informacione të tjera, siç është një raport vjetor, audituesi mund të marrë parasysh, nëse forma e paraqitjes lejon, identifikimin e numrave të faqeve në të cilat pasqyrat financiare të audituara janë paraqitur. Kjo ndihmon përdoruesit të identifikojnë pasqyrat financiare me të cilat lidhet raporti i audituesit.

“Paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale” ose “japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë”

- A24. Shprehjet “paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, ose “japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë” konsiderohen ekuivalente të njëra tjetrës. Fakti nëse shprehjet “paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, ose “japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë” janë përdorur në ndonjë juridiksion të caktuar, përcaktohet nga ligji ose rregullat që drejtojnë auditimin e pasqyrave financiare në atë juridiksion, ose nga praktika përgjithësisht e pranuar në atë juridiksion. Kur ligji apo rregullat kërkojnë përdorimin e një formulimi të ndryshëm, kjo nuk ndikon në kërkesën e paragrafit 14 të këtij SNA-je që audituesi, të vlerësojë paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë.
- A25. Kur audituesi shpreh një opinion të pamodifikuar, është e papërshtatshme që në lidhje me opinionin të përdoren shprehje të tilla si “sipas shpjegimit të mësipërm” ose “subjekt i”, sepse këto shprehje sugjerojnë një opinion të kushtëzuar ose të dobët ose modifikim të opinionit.

Përshkrimi i pasqyrave financiare dhe çështjeve që ato paraqesin

- A26. Opinioni i audituesit mbulon paketën e plotë të pasqyrave financiare të përcaktuara sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar. Për shembull, në rastin e shumë kuadrove për qëllime të përgjithshme, pasqyrat financiare mund të përfshijnë: pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve të parave, një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe informacione të tjera shpjeguese. Në disa juridiksione, informacioni shtesë, gjithashtu mund të konsiderohet si një pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.
- A27. Në rastin e pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, opinioni i audituesit deklaron se pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale, ose japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të çështjeve që pasqyrat financiare kanë për qëllim të paraqesin. Për shembull, në rastin e pasqyrave financiare të përgatitura sipas SNRF-ve, këto çështje janë *pozicioni financiar i entitetit në fund të periudhës dhe performanca financiare e entitetit dhe flukset e parave për periudhën e përfunduar në datën e fundit të periudhës*. Për pasojë shprehja [...] në paragrafin 25 dhe kudo në këtë SNA, synohet të zëvendësohet nga fjalët me shkrimin e pjerrët në fjalinë e mëparshme, kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar janë SNRF-të, ose në rastin e kuadrove të tjerë të zbatueshëm të raportimit financiar, nga fjalët që përshkruajnë çështjet që pasqyrat financiare kanë për qëllim të paraqesin.

Përshkrimi i kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar dhe mënyra se si ai mund të ndikojë në opinionin e audituesit

- A28. Identifikimi i kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar në opinionin e audituesit ka për qëllim të këshillojë përdoruesit e raportit të audituesit për kontekstin, në të cilin është shprehur opinionin e audituesit; ai nuk ka për qëllim të

kufizojë vlerësimin e kërkuar në paragrafin 14. Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është i identifikuar në terma të tilla si:

“... në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar” ose

“... në përputhje me parimet e kontabilitetit përgjithësisht të pranura në Juridiksionin X ...”

- A29. Kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përfshin standardet e raportimit financiar dhe kërkesat ligjore ose rregullatore, kuadri identifikohet në terma të tilla si “... në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe kërkesat e Ligjit të Shoqërive tregtare në Juridiksionit X”. SNA 210 merret me rrethanat ku ka konflikte mes standardeve të raportimit financiar dhe kërkesave ligjore ose rregullatore<sup>25</sup>.
- A30. Siç tregohet në paragrafin A8, pasqyrat financiare mund të jenë përgatitur në përputhje me dy kuadro të raportimit financiar, të cilët janë si pasojë të dy kuadro të zbatueshëm të raportimit financiar. Prandaj, secili kuadër konsiderohet veçmas në formulimin e opinionit të audituesit mbi pasqyrat financiare dhe opinionit i audituesit në përputhje me paragrafët 35-36 i referohet të dy kuadrove si vijon:
- (a) Nëse pasqyrat financiare janë në pajtueshmëri me secilin nga kuadrot në veçanti, dy opinione do të shprehen: që do të thotë, pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një nga kuadrot e zbatueshëm të raportimit financiar (për shembull, kuadrin kombëtar) dhe një opinion që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kuadrin tjetër të zbatueshëm të raportimit financiar (për shembull, SNRF-të). Këto opinione mund të shprehen veçmas ose në një fjali të vetme (për shembull, pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale [...]), në përputhje me parimet e kontabilitetit përgjithësisht të pranura në Juridiksionin X dhe me SNRF-të).
- (b) Nëse pasqyrat financiare janë në pajtueshmëri me një nga kuadrot, por nuk arrijnë të jenë në pajtueshmëri me kuadrin tjetër, mund të jepet një opinion i pamodifikuar që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me një kuadër (për shembull, kuadrin kombëtar), por një opinion i modifikuar duhet të jepet në lidhje me kuadrin tjetër (për shembull, SNRF-të) në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).
- A31. Siç tregohet në paragrafin A13, pasqyrat financiare mund të paraqesin pajtueshmëri me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe, përveç kësaj, të shtrijnë shkallën e pajtueshmërisë me një kuadër tjetër të raportimit financiar. Ky informacion shtesë mbulohet nga opinionit i audituesit, nëse ai nuk mund të diferencohet qartë nga pasqyrat financiare (shiko paragrafët 53-54 dhe materialin e zbatueshëm përkatës në paragrafët A78-A86). Përkatësisht,

<sup>25</sup>SNA 210, paragrafi 18



- (a) Nëse informacioni shpjegues përsa i përket pajtueshmërisë me kuadrin tjetër është çorientues, shprehet një opinion i modifikuar në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).
- (b) Nëse informacioni shpjegues nuk është çorientues, por audituesi e gjykon atë të jetë i një rëndësie të tillë që është themelore për të kuptuarit nga ana e përdoruesve të pasqyrave financiare, shtohet një Paragraf që Thekson Çështjen në përputhje me SNA 706 (i rishikuar), i cili tërheq vëmendjen tek informacioni shpjegues.

Baza për Opinionin (Ref: para. 28)

- A32. Seksioni i Bazës për Opinionin paraqet kontekstin e rëndësishëm për opinionin e audituesit. Përkatësisht, ky SNA kërkon që seksioni i Bazës për Opinionin të vijojë direkt pas seksionit të Opinionit në raportin e audituesit.
- A33. Referenca ndaj standardeve të përdorura përçon tek përdoruesit e raportit të audituesit informacionin që auditimi është kryer në përputhje me standardet e vendosura.

Kërkesat përkatëse etike

- A34. Identifikimi i juridiksionit të origjinës së kërkesave përkatëse etike rrit transparencën kundrejt këtyre kërkesave në lidhje me një angazhim auditimi të veçantë. SNA 200 shpjegon që kërkesat përkatëse etike zakonisht përfshijnë Pjesët A dhe B të Kodit të BSNEPK që kanë të bëjnë me një auditim të pasqyrave financiare së bashku me kërkesat kombëtare që janë më shtrënguese.<sup>26</sup> Kur kërkesat përkatëse etike përfshijë ato të Kodit të BSNEPK, deklarata mund t'i referohet gjithashtu Kodit të BSNEPK. Nëse Kodi i BSNEPK përmbledh të gjitha kërkesat etike që kanë të bëjnë me auditimin, nuk është e nevojshme që deklarata të identifikojë një juridiksion të origjinës.
- A35. Në disa juridiksione, kërkesat përkatëse etike mund të vijnë nga disa burime të ndryshme, siç mund të jenë kodi(et) etike, rregullat dhe kërkesat shtesë pjesë e ligjit dhe e rregullave. Kur pavarësia dhe kërkesat e tjera përkatëse etike vijnë nga një numër i kufizuar burimesh audituesi mund të zgjedhë që të japë emrin e burimit(eve) përkatës(e) (për shembull, emrin e kodit, rregullit ose rregullores së zbatueshme në atë juridiksion), ose mund t'i referohet termit që është gjerësisht i kuptueshëm dhe që në mënyrë të përshtatshme përmbledh këto burime (për shembull kërkesat e pavarësisë për auditimet e entiteteve private në Juridiksionin X).
- A36. Ligji ose rregullat, standardet kombëtare të auditimit ose kushtet e angazhimit mund të kërkojnë që audituesi të japë në raportin e auditimit më shumë

---

<sup>26</sup>SNA 200, paragrafi A14

informacion specifik lidhur me burimet e kërkesave përkatëse etike, përfshirë ato që i përkasin pavarësisë, të cilat zbatohen në auditimin e pasqyrave financiare.

- A37. Në përcaktimin e masës së informacionit që duhet përfshirë në raportin e audituesit kur janë disa burime të kërkesave etike, të cilat kanë të bëjnë me auditimin e paqyrave financiare, një konsideratë e veçantë duhet t'i jepet mbajtjes në ekuilibër të transparencës kundrejt fshehjes së informacionit tjetër të dobishëm në raportin e audituesit.

Konsiderata specifike për auditimet e grupit

- A38. Në auditimet e grupit ku ka shumë burime të kërkesave përkatëse etike, përfshirë ato që i përkasin pavarësisë, referenca për juridiksionin në raportin e audituesit zakonisht ka të bëjë me kërkesat përkatëse etike që janë të zbatueshme për ekipin e angazhimit të grupit. Kjo për arsye se në auditimin e grupit, audituesit e entitetit të kontrolluar i nënshtrohen gjithashtu kërkesave etike që i përkasin auditimit të grupit.<sup>27</sup>
- A39. SNA-të nuk vendosin kërkesa specifike për pavarësinë ose kërkesat etike për audituesit, përfshirë audituesit e entitetit të kontrolluar, dhe kështu nuk shtrijnë ose mbivendosin kërkesat e pavarësisë së Kodit të Etikës ose kërkesat e tjera etike të cilave ju nënshtrohet ekipi i angazhimit të grupit, gjithashtu SNA-të nuk kërkojnë që audituesi i entitetit të kontrolluar në të gjitha rastet t'i nënshtrohet të njëjtave kërkesa specifike të pavarësisë që janë të zbatueshme për ekipin e angazhimit të grupit. Si rezultat, kërkesat përkatëse etike, përfshirë ato që i përkasin pavarësisë, në situatën e një auditimi të grupit mund të jenë komplekse. SNA 600<sup>28</sup> jep udhëzime për audituesit në kryerjen e punës mbi pasqyrat financiare të një entiteti të kontrolluar në një auditim të grupit, përfshirë ato situata kur audituesi i entitetit të kontrolluar nuk përmbush kërkesat e pavarësisë të cilat i përkasin auditimit të grupit.

Çështjet Kryesore të Auditimit

- A40. Ligji ose rregullat mund të kërkojnë komunikimin e çështjeve kryesore të auditimit për auditimet e entiteteve jo të listuara, për shembull entitete që sipas këtij ligji ose këtyre rregullave karakterizohen si entitete me interes publik.
- A41. Audituesi mundet gjithashtu, të vendosë të komunikojë çështjet kryesore të auditimit për entitete të tjera, përfshirë ato që mund të jenë me interes të konsiderueshëm publik, për shembull, sepse ato mund të kenë një numër të madh dhe një gamë të gjerë palësh të interesuara dhe duke marrë në konsideratë natyrën dhe madhësinë e biznesit. Shembuj të entiteteve të tilla mund të

<sup>27</sup>SNA 600, paragrafi A37

<sup>28</sup>SNA 600, paragrafët 19-20

përfshijnë insitucionet financiare (siç janë bankat, kompanitë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve), dhe entitete të tjera siç janë institucionet e bamirësisë.

- A42. SNA 210 kërkon që audituesi të bjerë dakord për kushtet e angazhimit të auditimit me drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen, nëse është e përshtatshme, dhe shpjegon që rolet e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në rënien dakord me kushtet e angazhimit të auditimit për entitetin varen nga marrëveshjet qeverisëse të entitetit dhe ligji ose rregullat përkatëse.<sup>29</sup> SNA 210 kërkon gjithashtu, që letra e angazhimit të auditimit ose forma tjetër e përshtatshme e marrëveshjes me shkrim të përfshijë një referencë për formën dhe përmbajtjen e pritshme të çdo raporti që do të lëshohet nga audituesi.<sup>30</sup> Kur audituesit nuk i kërkohet përndryshe, të komunikojë çështjet kryesore të auditimit, SNA 210<sup>31</sup> shpjegon se mund të jetë e dobishme për audituesin që ai të bëjë një referencë në kushtet e angazhimit të auditimit për mundësinë e komunikimit të çështjeve kryesore të auditimit në raportin e audituesit dhe, në juridiksione të caktuara, është e nevojshme që audituesi të përfshijë një referencë për një mundësi të tillë në mënyrë që ai të ruajë aftësinë për të vepruar në këtë mënyrë.

Konsiderata specifike për entitetet e sektorit publik

- A43. Entitetet e listuara nuk janë të zakonshme në sektorin publik. Megjithatë, entitetet e sektorit publik mund të jenë të rëndësishme për shkak të madhësisë, kompleksitetit ose aspekteve të interesit publik. Në raste të tilla, audituesit të një entiteti të sektorit publik mund t'i kërkohet nga ligji ose rregullat, ose përndryshe, të vendosë të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit.

Përgjegjësitë për Pasqyrat Financiare (Ref: Para. 33-35)

- A44. SNA 200 shpjegon pranimin, lidhur me përgjegjësitë e drejtimit dhe, kur është e përshtatshme, të personave të ngarkuar me qeverisjen, mbi të cilin është kryer një auditim në përputhje me SNA-të<sup>32</sup>. Drejtimi dhe, ku është e përshtatshme, personat e ngarkuar me qeverisjen pranojnë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, paraqitjen e tyre të drejtë. Drejtimi, gjithashtu, pranon përgjegjësinë për kontrollin e tilla të brendshme, që ai i përcakton si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk kanë anomali materiale, qofshin këto për shkak të mashtrimit apo gabimit. Përshkrimi i përgjegjësive të drejtimit në raportin e audituesit përfshin referencë për të dy përgjegjësitë, pasi ai ndihmon t'u shpjegojë përdoruesve pranimin, mbi të cilin një auditim është kryer. SNA 260 (i rishikuar)

<sup>29</sup>SNA 210, paragrafët 9 dhe A21

<sup>30</sup>SNA 210, paragrafi 10

<sup>31</sup>SNA 210, paragrafi A23a

<sup>32</sup>SNA 200, paragrafi 13 (j)

përdor termin personat e ngarkuar me qeverisjen për të përshkruar personin(at) që kanë përgjegjësinë për mbikëqyrjen e entitetit, dhe paraqet një diskutim rreth larmisë së strukturave qeverisëse në juridiksione dhe entitete të ndryshme.

- A45. Mund të ketë rrethana, kur për audituesin, është e përshtatshme të shtojë në përshkrimet e përgjegjësiave të drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen që jepen në paragrafët 34-35, për të reflektuar përgjegjësitë shtesë që janë të përshtatshme për përgatitjen e pasqyrave financiare në kontekstin e juridiksionit të caktuar ose të natyrës së entitetit.
- A46. SNA 210 kërkon që audituesi të pranojë përgjegjësitë e drejtimit në një letër angazhimi ose në forma të tjera të përshtatshme të marrëveshjeve të shkruara<sup>33</sup>. SNA 210 ofron fleksibilitet në këtë gjë, duke shpjeguar se, nëse ligji ose rregulli përshkruan përgjegjësitë e drejtimit dhe, kur kjo është e përshtatshme, të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me raportimin financiar, audituesi mund të përcaktojë se ligji ose rregulli përfshin përgjegjësitë që, në gjykimin e audituesit janë të njëvlershme në efekt me ato të përcaktuara në SNA 210. Për përgjegjësi të tilla që janë të njëvlershme, audituesi mund të përdorë formulimin e ligjit ose rregullit për t'i përshkruar ato në letrën e angazhimit ose në forma të tjera të përshtatshme të marrëveshjes së shkruar. Në raste të tilla, ky formulim gjithashtu, mund të përdoret në raportin e audituesit për të përshkruar përgjegjësitë e drejtimit, siç kërkohet në paragrafin 34(a). Në rrethana të tjera, duke përfshirë edhe rastin kur audituesi vendos të mos përdorë formulimin e ligjit ose të rregullit siç përmbahet në letrën e angazhimit, do të përdoret formulimi i paragrafit 34(a) të këtij SNA-je. Përveç përfshirjes së përshkrimit në raportin e audituesit të përgjegjësiave të drejtimit siç kërkohet nga paragrafi 34, audituesi mund t'i referohet një përshkrimi akoma më të detajuar të këtyre përgjegjësiave, duke përfshirë një referencë se ku mund të sigurohet ky informacion (për shembull në raportin vjetor të entitetit ose në faqen e internetit të autoritetit të përshtatshëm).
- A47. Në disa juridiksione, ligji ose rregullat që përshkruajnë përgjegjësitë e drejtimit mund t'i referohen në mënyrë specifike një përgjegjësie për përshtatshmërinë e librave kontabël dhe regjistrimeve kontabël ose të sistemit kontabël. Duke qenë se librat, regjistrimet dhe sistemet janë një pjesë përbërëse e kontrollit të brendshëm (siç përcaktohet në SNA 315 (i rishikuar)<sup>34</sup>), përshkrimet në SNA 210 dhe në paragrafin 34 nuk bëjnë ndonjë lidhje specifike me to.
- A48. Shtojca e këtij SNA-je jep ilustrime sesi kërkesat në paragrafin 34(b) mund të zbatohen kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar janë SNRF-të. Nëse është përdorur një kuadër i zbatueshëm i raportimit financiar i ndryshëm nga SNRF-të, deklaratat ilustruese të paraqitura në Shtojcën e këtij SNA-je mund të jetë e nevojshme të përshataten për të reflektuar zbatimin e kuadrit tjetër të zbatueshëm të raportimit financiar për rrethanat e dhëna.

<sup>33</sup>SNA 210, paragrafi 6(b)(i)-(ii)

<sup>34</sup>SNA 315, *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të tij*, paragrafi 4(c)

Mbikëqyrja e procesit të raportimit financiar (Ref: Para. 35)

A49. Kur disa nga, por jo të gjithë individët e përfshirë në mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar janë përfshirë gjithashtu, në përgatitjen e pasqyrave financiare, përshkrimi siç kërkohet në paragrafin 35 të këtij SNA-je, mund të jetë e nevojshme të modifikohet për të reflektuar në mënyrë të përshtatshme rrethanat specifike të entitetit. Kur individët përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar janë të njëjtët me ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare, nuk është e nevojshme të bëhet një referencë lidhur me përgjegjësitë e mbikëqyrjes.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (Ref: Para.37-40)

A50. Përshkrimi i përgjegjësive të audituesit siç kërkohet nga paragrafët 37-40 të këtij SNA-je mund të përshtatet për të reflektuar natyrën specifike të entitetit, për shembull, kur raporti i audituesit trajton pasqyrat financiare të konsoliduara. Ilustrimi 2 në Shtojcën e këtij SNA-je përfshin një shembull sesi mund të bëhet ky përshkrim.

Objektivat e audituesit (Ref: Para. 38(a))

A51. Raporti i audituesit shpjegon se objektivat e audituesit janë që të arrijë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojë një raport auditimi që përfshin opinionin e audituesit. Këto objektiva dallojnë në mënyrë të qartë nga përgjegjësitë e drejtimit për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Përshkrimi i materialitetit (Ref: Para. 38(c))

A52. Shtojca e këtij SNA-je jep ilustrime për mënyrën sesi kërkesat në paragrafin 38(c) mund të zbatohen kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar janë SNRF-të. Nëse është përdorur një kuadër i zbatueshëm i raportimit financiar i ndryshëm nga SNRF-të, deklaratat ilustruese të paraqitura në Shtojcën e këtij SNA-je mund të jetë e nevojshme të përshtaten për të reflektuar zbatimin e kuadrit tjetër të zbatueshëm të raportimit financiar për rrethanat e dhëna.

Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me SNA 701 (Ref: Para. 40(c))

A53. Për të përshkruar përgjegjësitë e tij, audituesi mund të vlerësojë të dobishme, dhënien e informacioneve shtesë përtej sa kërkohet në paragrafin 40(c). Për shembull, për të përcaktuar çështjet që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme nga audituesi gjatë kryerjes së auditimit, audituesi mund të bëjë referencë në paragrafin 9 të SNA 701, duke marrë parasysh fushat me rrezik të anomalisë materiale të vlerësuar të lartë ose me rreziqe të rëndësishme në përputhje me

SNA 315 (i rishikuar); gjykimet e rëndësishme të audituesit në lidhje me fushat e pasqyrave financiare që përfshijnë gjykime të rëndësishme të drejtimit, përfshirë çmuarjet kontabël që kanë qenë identifikuar me pasiguri të lartë të çmuarjes; dhe efektet në auditim, të ngjarjeve dhe transaksioneve të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës.

Vendndodhja e përshkrimit të përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (Ref: Para. 41, 50(k))

A54. Përfshirja e informacionit të kërkuar nga paragrafët 39-40 të këtij SNA-je, në një shtojcë të raportit të audituesit ose kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht referimin tek faqja e internetit e autoritetit të përshtatshëm që përmban një informacion të tillë, mund të jetë një mënyrë e dobishme për të modernizuar përmbajtjen e raportit të audituesit. Megjithatë, duke qenë se përshkrimi i përgjegjësive të audituesit përmban informacion që është i nevojshëm për të informuar pritshmëritë e përdoruesve lidhur me një auditim të kryer në pajtim me SNA-të, është e nevojshme që në raportin e audituesit, të përfshihet një referencë e cila të tregojë vendin ku mund të gjendet një informacion i tillë.

Vendndodhja në një shtojcë (Ref: Para. 41(b), 50(k))

A55. Paragrafi 41 e lejon audituesin që të përfshijë deklaratat e kërkuara nga paragrafët 39-40 të cilat përshkruajnë përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare, në një shtojcë të raportit të audituesit, me kusht që të jetë bërë një referencë e përshtatshme brenda trupit të raportit të audituesit lidhur me vendndodhjen e shtojcës. Në vijim jepet një ilustrim sesi mund të bëhet një referencë e tillë në raportin e audituesit:

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo të gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim i mëtejshëm i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në shtojcën X të këtij raporti të audituesit. Ky përshkrim, i cili ndodhet në [trego numrin e faqes ose referencën tjetër

*specifike lidhur me vendndodhjen e përshkrimit*], është pjesë e raportit tonë të audituesit.

Referenca tek faqja e internetit e autoritetit të përshtatshëm

- A56. Paragrafi 41 shpjegon se audituesi mund t'i referohet përshkrimit të përgjegjësive të audituesit që ndodhet në faqen e internetit të autoritetit të përshtatshëm, vetëm nëse lejohet shprehimisht nga ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit. Informacioni në faqen e internetit që është përfshirë në raportin e audituesit nëpërmjet një reference specifike tek vendndodhja e faqes së internetit ku mund të gjendet një informacion i tillë, mund të përshkruajë punën e audituesit, ose më gjerë auditimin në pajtim me SNA-të, por nuk mund të jetë në kundërshtim me përshkrimin e kërkuar në paragrafët 39-40 të këtij SNA-je. Kjo do të thotë që formulimi i përdorur në përshkrimin e përgjegjësive të audituesit në faqen e web-it mund të jetë më i detajuar, ose mund të trajtojë çështje që kanë të bëjnë me një auditim të pasqyrave financiare, duke siguruar që një formulim i tillë reflekton dhe nuk kundërshton çështjet e trajtuara në paragrafët 39-40.
- A57. Autoriteti i përshtatshëm mund të jetë një hartues i standardeve kombëtare të auditimit, një rregullator, ose një organizëm i mbikëqyrjes së auditimit. Këto organizma kanë pozicionimin e duhur për të siguruar saktësinë, plotësinë dhe disponueshmërinë e vazhdueshme të informacionit të standardizuar. Nuk do të kishte kuptim që audituesi të mirëmbajë një faqe të tillë. Në vijim jepet një ilustrim sesi mund të bëhet një referencë e tillë tek një faqe në internet në raportin e audituesit:

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo të gabimit, dhe të lëshojmë një raport të audituesit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim i mëtijshëm i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në faqen e internetit të (*Organizatës*) në: [*linku i faqes në web*]. Ky përshkrim është pjesë e raportit tonë të audituesit.

## Përgjegjësi të Tjera të Raportimit (Ref: Para.43-45)

- A58. Në disa juridiksione, audituesi mund të ketë përgjegjësi shtesë për të raportuar mbi çështje të tjera, që janë plotësuese për përgjegjësitë e audituesit sipas SNA-ve. Për shembull, audituesit mund t'i kërkohej të raportojë për çështje të caktuara, nëse ato vijnë në vëmendjen e tij gjatë auditimit të pasqyrave financiare. Përndryshe, audituesit mund t'i kërkohej të kryejë dhe të raportojë mbi procedurat specifike shtesë, ose të shprehë një opinion për çështje specifike, të tilla si përshtatshmëria e librave të kontabilitetit dhe regjistrimeve kontabël, kontrollit të brendshëm mbi raportimin financiar ose informacione të tjera. Standardet e auditimit në juridiksionin e caktuar, shpesh japin udhëzime mbi përgjegjësitë e audituesit në lidhje me përgjegjësitë specifike shtesë të raportimit në atë juridiksion.
- A59. Në disa raste, ligji ose rregullat përkatëse mund të kërkojnë ose të lejojnë që audituesi të raportojë mbi këto përgjegjësi të tjera si pjesë e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare. Në raste të tjera, audituesit mund t'i kërkohej ose ai mund të lejohet të raportojë mbi to në një raport të veçantë.
- A60. Paragrafët 43-45 të këtij SNA-je lejojnë paraqitjen e kombinuar të përgjegjësive të tjera dhe të përgjegjësive të audituesit sipas SNA-ve, vetëm në rastin kur ato trajtojnë të njëjtat çështje dhe formulimi i raportit të audituesit diferencon qartë përgjegjësitë e tjera nga ato sipas SNA-ve. Ky diferencim i qartë, mund të bëjë të nevojshëm faktin që raporti i audituesit t'i referohet burimit të përgjegjësive të tjera raportuese dhe të citojë që këto përgjegjësi janë përtej atyre të kërkuara sipas SNA-ve. Përndryshe, përgjegjësitë e tjera të raportimit, kërkohej që të trajtohen në një seksion të veçantë të raportit të audituesit me titull “Raporti mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore” ose përndryshe, në një formë që mund të jetë e përshtatshme për përmbajtjen e seksionit. Në raste të tilla, paragrafi 44 kërkon që audituesi të përfshijë përgjegjësitë raportuese sipas SNA-ve nën titullin “Raporti mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare”.

## Emri i Ortakut të Angazhimit (Ref: Para.46)

- A61. SNKC 1<sup>35</sup> kërkon që firma të vendosë politika dhe procedura për të dhënë sigurinë e arsyeshme që angazhimet kryhen në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Pavarësisht kërkesave të SNKC 1, vendosja e emrit të ortakut të angazhimit në raportin e audituesit synon t'ju japë transparencë më të madhe përdoruesve të raportit të audituesit të paketës së plotë të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entitetit të listuar.
- A62. Ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit, mund të kërkojnë që raporti i audituesit të përfshijë emrin e ortakut të angazhimit përgjegjës për auditimet që

<sup>35</sup> SNKC 1, *Kontrolli i Cilësisë për Firmat që kryejnë Auditime dhe Rishikime të Pasqyrave Financiare, dhe Angazhime të Tjera të Tjera të Sigurisë dhe të Shërbimeve të Lidhura*, paragrafi 32



ndryshojnë nga auditimet për pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara. Audituesit mund t'i kërkohej nga ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit, ose mund të vendosë të përfshijë në raportin e audituesit informacion shtesë, përtej emrit të ortakut të angazhimit për të identifikuar më tej ortakun e angazhimit, për shembull numrin e licencës profesionale sipas juridiksionit ku audituesi ushtron veprimtarinë.

- A63. Në rrethana të rralla, audituesi mund të marrë informacion ose të jetë pjesë e eksperiencave që tregojnë se ka të ngjarë të ketë kërcënime të sigurisë personale në rast se identiteti i ortakut të angazhimit është bërë publik, gjë e cila mund të çojë në dëmtim fizik të ortakut të angazhimit, të anëtarëve të tjerë të ekipit të angazhimit ose të individëve të tjerë të lidhur ngushtë me ta. Megjithatë, një kërcënim i tillë, nuk përfshin për shembull, shkeljet e detyrimeve ligjore, sanksioneve ligjore, rregullatore dhe profesionale. Diskutimet me personat e ngarkuar me qeverisjen për rrethanat, të cilat mund të çojnë në dëmtim fizik, mund të sigurojnë informacion shtesë lidhur me gjasat ose seriozitetin e kërcënimit të sigurisë personale. Ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit mund të vendosin kërkesa shtesë lidhur me përcaktimin nëse mund të përjashtohet bërja e ditur e emrit të ortakut të angazhimit.

Nënshkrimi i Audituesit (Ref: Para. 47)

- A64. Nënshkrimi i audituesit është ose në emër të firmës audituese, në emrin personal të audituesit, apo të dyja bashkë, cilado që është më e përshtatshme në juridiksionin e veçantë. Përveç nënshkrimit të audituesit, në disa juridiksione, audituesit mund t'i kërkohej të deklarojë në raportin e audituesit, titullin e organizmit profesional që ai mban ose faktin që audituesi apo firma, sipas rastit, është e njohur nga autoriteti i përshtatshëm i licencimit në atë juridiksion.
- A65. Në disa raste, ligji ose rregullat mund të lejojnë përdorimin e nënshkrimit elektronik në raportin e audituesit.

Data e Raportit të Audituesit (Ref: Para. 49)

- A66. Data e raportit të audituesit informon përdoruesin e këtij raporti që audituesi ka marrë në konsideratë efektin e ngjarjeve dhe transaksioneve, për të cilat audituesi është vënë në dijeni dhe që kanë ndodhur deri në atë datë. Përgjegjësia e audituesit për ngjarjet dhe transaksionet pas datës së raportit të audituesit është trajtuar në SNA 560<sup>36</sup>.
- A67. Duke qenë se opinioni i audituesit është dhënë mbi pasqyrat financiare dhe pasqyrat financiare janë përgjegjësi e drejtimit, audituesi nuk është në gjendje për të arritur në përfundimin se është siguruar evidenca e nevojshme e auditimit derisa të jetë siguruar evidenca që tregojnë se janë përgatitur të gjitha pasqyrat dhe

<sup>36</sup>SNA 560, *Ngjarjet e Mëvonshme*, paragrafët 10-17

informacionet shpjeguese që përfshihen në pasqyrat financiare, dhe drejtimi ka pranuar përgjegjësinë për to.

- A68. Në disa juridiksione, ligji ose rregullat identifikojnë individët ose organet (për shembull, drejtorët) që janë përgjegjës për të për të arritur në përfundimin se të gjitha pasqyrat dhe informacionet shpjeguese që përfshihen në pasqyrat financiare janë përgatitur, dhe specifikon procesin e nevojshëm të miratimit. Në raste të tilla, evidenca për këtë miratim është marrë përpara vendosjes së datës në raportin mbi pasqyrat financiare. Megjithatë, në juridiksione të tjera, procesi i aprovimit nuk është përshkruar në ligj ose në rregulla. Në raste të tilla, merren në konsideratë procedurat që ndjek entiteti për përgatitjen dhe finalizimin e pasqyrave të veta financiare në këndvështrimin e funksioneve të drejtimit dhe strukturave të tij qeverisëse, në mënyrë që të identifikohen individët apo organi që ka autoritetin për të arritur në përfundimin se janë përgatitur të gjitha pasqyrat që përfshijnë pasqyrat financiare, përfshirë shënimet shpjeguese përkatëse. Në disa raste, ligji ose rregulli identifikon pikën në procesin e raportimit të pasqyrave financiare, në të cilën pritet të përfundohet auditimi.
- A69. Në disa juridiksione, aprovimi përfundimtar i pasqyrave financiare nga aksionerët kërkohet të bëhet para se pasqyrat financiare të publikohen. Në këto juridiksione, nuk është i nevojshëm aprovimi përfundimtar nga aksionerët, që audituesi të arrijë në përfundimin se është siguruar evidenca e nevojshme e auditimit. Data e aprovimit të pasqyrave financiare për qëllime të SNA-ve, është data më e hershme, në të cilën individët me autoritet të njohur deklarojnë se janë përgatitur të gjitha pasqyrat dhe informacionet shpjeguese që përfshihen në pasqyrat financiare, dhe se ata me autoritet të njohur kanë pohuar që kanë marrë përgjegjësinë për to.

*Raporti i Audituesit i Përshkruar nga Ligji ose Rregullat (Ref: Para.50)*

- A70. SNA 200 shpjegon se audituesit mund t'i kërkohet që përveç kërkesave të SNA-ve, të veprojnë edhe në pajtim me kërkesat ligjore ose rregullatore.<sup>37</sup>Kur dallimet mes kërkesave ligjore ose rregullatore dhe SNA-ve kanë të bëjnë vetëm me paraqitjen dhe formulimin e raportit të audituesit, kërkesat në paragrafin 50(a)-(o) përcaktojnë elementët që minimalisht duhen përfshirë në raportin e audituesit për të bërë të mundur që raporti t'i referohet Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Në rrethana të tilla, kërkesat në paragrafët 21-49 që nuk janë përfshirë në paragrafin 50(a)-(o) nuk është e nevojshme të zbatohen duke përfshirë, për shembull, renditjen e kërkuar të seksioneve të Opinioneve dhe Bazës për Opinioneve.
- A71. Kur kërkesat specifike në një juridiksion të caktuar nuk bien ndesh me SNA-të, paraqitja dhe formulimi i kërkuar nga paragrafët 21-49 të këtij SNA-je, ndihmon

<sup>37</sup>SNA 200, paragrafi A55

përdoruesit e raportit të audituesit, të njohin më lehtë raportin e audituesit si një raport mbi një auditim të kryer në përputhje me SNA-të.

Informacioni i Kërkuar nga SNA 701 (Ref: Para. 50(h))

- A72. Ligji apo rregullat mund të kërkojnë që audituesi të sigurojë informacion shtesë në lidhje me auditimin e kryer, i cili mund të përfshijë informacionin që është në pajtim me objektivat e SNA 701, ose mund të përshkruajë natyrën dhe shtrirjen e komunikimit në lidhje me këto çështje.
- A73. SNA-të nuk anashkalojnë ligjin apo rregullat që mbulojnë auditimin e pasqyrave financiare. Kur zbatohet SNA 701, referenca tek SNA-të mund të bëhet në raportin e audituesit vetëm nëse, në zbatim të ligjit ose rregullave, seksioni i kërkuar nga paragrafi 50(h) i këtij SNA-je, nuk është në kundërshtim me kërkesat e raportimit sipas SNA 701. Në rrethana të tilla, audituesi mund të ketë nevojë të përshtatë, në raportin e audituesit, disa aspekte të komunikimit të çështjeve kryesore të auditimit, të kërkuara nga SNA 701, për shembull:
- Të modifikojë titullin "Çështjet Kryesore të Auditimit", në qoftë se ligji apo rregullat parashikojnë një titull të veçantë;
  - Të shpjegojë pse informacioni i kërkuar me ligj ose nga rregullat, është dhënë në raportin e audituesit, për shembull, duke bërë një referencë në ligj ose rregullin përkatës dhe duke përshkruar se si ky informacion lidhet me çështjet kryesore të auditimit;
  - Aty ku ligji ose rregullat përcaktojnë natyrën dhe shkallën e shtrirjes së përshkrimit, të plotësojë informacionin e kërkuar për të arritur një përshkrim të përgjithshëm të secilës çështje kryesore të auditimit, që është në përputhje me kërkesën në paragrafin 13 të SNA 701.
- A74 SNA 210 ka të bëjë me rastet kur ligji ose rregullat e juridiksionit përkatës përcaktojnë paraqitjen ose formulimin e raportit të audituesit në kushtet që janë dukshëm të ndryshme nga kërkesat e SNA-ve, të cilat në mënyrë të veçantë përfshijnë opinionin e audituesit. Në këto rrethana, SNA 210 kërkon që audituesi të vlerësojë:
- (a) Nëse përdoruesit mund të keqkuptojnë sigurinë e dhënë nga auditimi i pasqyrave financiare dhe, nëse po,
  - (b) Nëse shpjegimi shtesë, në raportin e audituesit, mund të zvogëlojë keqkuptimin e mundshëm.

Nëse audituesi arrin në përfundimin se shpjegimi shtesë i dhënë në raport, nuk mund të zvogëlojë keqkuptimin e mundshëm, SNA 210 kërkon nga audituesi të mos pranojë angazhimin e auditimit, përveç nëse nga ligji ose rregullat kërkohet

që të veprohet në këtë mënyrë. Në përputhje me SNA 210, një auditim i kryer në përputhje me një ligj ose rregull të tillë nuk është në pajtim me SNA-të. Prandaj, audituesi në raportin e audituesit nuk përfshin ndonjë referencë për auditimin, ku të tregohet se ai është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.<sup>38</sup>

#### Konsiderata specifike për entitetet e sektorit publik

A75 Audituesit e entiteteve të sektorit publik mund të kenë mundësinë sipas ligjit ose rregullave, për të raportuar publikisht për çështje të caktuara, qoftë në raportin e audituesit, apo në raportin plotësues, i cili mund të përfshijë informacionet që janë në koherencë me objektivat e SNA 701. Në këto rrethana, audituesit mund të ketë nevojë të përshtasë në raportin e audituesit, disa aspekte të komunikimit të çështjeve kryesore të auditimit të kërkuara nga SNA 701 ose të përfshijë një referencë në raportin e audituesit për një përshkrim të çështjes në raportin plotësues.

*Raporti i Audituesit për Auditimet e Kryera në Përputhje si me Standardet e Auditimit të një Juridiksioni të Veçantë dhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (Ref: Para.51)*

A76 Në raportin e audituesit, audituesi mund t'i referohet auditimit që është kryer në përputhje si me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe me standardet kombëtare të auditimit kur, përveç përputhjes me standardet përkatëse kombëtare të auditimit, audituesi vepron në pajtim me secilin prej SNA-ve që kanë lidhje me auditimin<sup>39</sup>.

A77. Një lidhje mes Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe standardeve kombëtare të auditimit nuk është e përshtatshme nëse ka konflikt mes kërkesave të SNA-ve dhe atyre të standardeve kombëtare të auditimit, të cilat mund të bëjnë që audituesi të krijojë një opinion të ndryshëm ose mos të përfshijë një paragraf që Thekson Çështjen ose një Paragraf për Çështje të Tjera, që në rrethana të veçanta, kërkohet nga SNA-të. Në një rast të tillë, raporti i audituesit i referohet vetëm standardeve të auditimit (ose Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit apo standardeve kombëtare të auditimit) në përputhje me të cilat është përgatitur raporti i audituesit.

**Informacioni Plotësues i Paraqitur së Bashku me Pasqyrat Financiare (Ref: Para.53-54)**

A78. Në disa rrethana, entitetit mund t'i kërkohet nga ligji, rregullat ose standardet, ose ai mund të zgjedhë vullnetarisht, të paraqesë së bashku me pasqyrat financiare, edhe informacion plotësues që nuk është kërkuar nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar. Për shembull, informacioni plotësues mund të paraqitet për

<sup>38</sup>SNA 210, paragrafi 21

<sup>39</sup>SNA 200, paragrafi A56

të përmirësuar kuptimin nga përdoruesit të kuadrin të zbatueshëm të raportimit financiar ose për të dhënë më tepër shpjegime për zëra të veçantë të pasqyrave financiare. Ky informacion, normalisht paraqitet ose në tabela plotësuese ose në formën e shënimeve shpjeguese shtesë.

A79. Paragrafi 53 i këtij SNA-je shpjegon që opinioni i audituesit mbulon informacion plotësues që është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare për shkak të natyrës së tij ose mënyrës se si ai është paraqitur. Ky vlerësim është çështje e gjykitimit profesional. Për ta ilustruar:

- Kur shënimet në pasqyrat financiare përfshijnë një shpjegim ose rakordim të masës në të cilën pasqyrat financiare përputhen me një kuadër tjetër të raportimit financiar, audituesi mund ta konsiderojë këtë si informacion plotësues, që nuk mund të diferencohet qartë nga pasqyrat financiare. Opinioni i audituesit, gjithashtu, do të mbulonte shënimet ose tabelat plotësuese që janë lidhur me pasqyrat financiare me referenca të kryqëzuara.
- Kur një pasqyrë shtesë e fitimeve dhe humbjeve që jep informacion për elementë specifikë të shpenzimeve paraqitet në një tabelë të veçantë, e përfshirë në një Shtojcë të pasqyrave financiare, audituesi mund ta konsiderojë këtë informacion plotësues, që mund të diferencohet qartë nga pasqyrat financiare.

A80. Informacioni plotësues që është mbuluar nga opinioni i audituesit nuk ka nevojë të përmendet specifikisht në raportin e audituesit, kur është e mjaftueshme referenca tek shënimet në përshkrimin e pasqyrave që përbëjnë pasqyrat financiare.

A81. Ligji ose rregullat mund të mos kërkojnë që informacioni plotësues të auditohet, dhe drejtimi mund të vendosë t'i kërkojë audituesit që të mos e përfshijë informacionin plotësues brenda fushës së auditimit të pasqyrave financiare.

A82. Vlerësimi i audituesit nëse informacioni plotësues i paaudituar është paraqitur në një mënyrë që mund të interpretohet si i mbuluar nga opinioni i audituesit përfshin, për shembull, rastin kur ky informacion është paraqitur në lidhje me pasqyrat financiare dhe është informacion plotësues i paaudituar, dhe nëse ai është emërtuar qartë si “i paaudituar”.

A83. Drejtimi mund të ndryshojë paraqitjen e informacionit plotësues të paaudituar që mund të interpretohet si i mbuluar nga opinioni i audituesit, për shembull:

- Duke hequr çdo referencë të kryqëzuar nga pasqyrat financiare tek tabelat plotësuese të paaudituar ose shënimet e paaudituar, në mënyrë që kufiri mes informacionit të audituar dhe paaudituar të jetë mjaftueshëm i qartë.
- Duke e vendosur informacionin plotësues të paaudituar jashtë pasqyrave financiare ose, nëse nuk është e mundur nga rrethanat, së paku duke vendosur

shënimet e paaudituarra së bashku, në fund të shënimeve të kërkuara në pasqyrat financiare dhe t'i emërtojë ato qartë si të paaudituarra. Shënimet e paaudituarra që janë përzier me shënimet e audituarra mund të keqinterpretohen duke u marrë si të audituarra.

A84. Fakti që informacioni plotësues është i paaudituar nuk e çliron audituesin nga përgjegjësitë e përshkruara në SNA 720 (i rishikuar)<sup>40</sup>.

**Shtojcë**  
(Ref:Para. A19)

### **Ilustrime të Raporteve të Audituesit të Pavarur mbi Pasqyrat Financiare**

- Ilustrimi 1: Një raport i audituesit mbi pasqyrat financiare të një entiteti të listuar, të përgatitura në përputhje me kuadër të paraqitjes së drejtë
- Ilustrimi 2: Një raport i audituesit mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të një entiteti të listuar, të përgatitura në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë
- Ilustrimi 3: Një raport i audituesit mbi pasqyrat financiare të një entiteti të pa listuar, të përgatitura në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë (ku referenca është bërë tek materiali që ndodhet në faqen e internetit të autoritetit të përshtatshëm)
- Ilustrimi 4: Një raport i audituesit mbi pasqyrat financiare të një entiteti të pa listuar, të përgatitura në përputhje me një kuadër të pajtueshmërisë për qëllime të përgjithshme

---

<sup>40</sup>SNA 720 (I rishikuar), *Përgjegjësitë e Audituesit në Lidhje me Informacionet e Tjera*

**Ilustrimi 1: Raporti i Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të një Entiteti të Listuar, të Përgatitura në Përputhje me një Kuadër të Paraqitjes së Drejtë**

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th.nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin përfshijnë *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël së bashku me kërkesat etike që lidhen me auditimin të juridiksionit, dhe audituesi i referohet të dyjave.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar informacionet e tjera përpara datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar ndonjë anomali materiale në këto informacione.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen nga legjislati lokal.

**RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

Për Aksionarëte Shoqërisë Tregtare ABC [ose një Adresë Tjetër e Duhur]

**Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare<sup>41</sup>****Opinionin**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (*ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për*), pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK)* së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në *[juridiksionin]*, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Çështjet Kryesore të Auditimit**

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

<sup>41</sup>Nën-titulli “Raporti mbi Pasqyrat Financiare” është i panevojshëm në rrethana kur nën-titulli i dytë “Raporti mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore” nuk është i mundur.



## **Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]**

*[Raportimi në përputhje me kërkesat e raportimit në SNA 720 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në Shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar).]*

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare<sup>42</sup>**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të<sup>43</sup>, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Paragrafi 41(b) i këtij SNA-je shpjegon se materiali i hijëzuar më poshtë mund të vendoset në një Shtojcë të raportit të audituesit. Paragrafi 41(c) shpjegon se referenca mund të bëhet tek faqja e internetit e autoritetit të përshtatshëm e cila përmban përgjegjësitë e audituesit, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht, në vend që ta përfshijmë këtë material në raportin e audituesit,

<sup>42</sup>Gjatë gjithë këtyre raporteve ilustruese të audituesit, termat drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen mund të jetë e nevojshme të zëvendësohen nga terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

<sup>43</sup>Kur përgjegjësia e drejtimit është të përgatitë pasqyra financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, kjo mund të lexohet: “Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për të tilla ...”

duke u siguruar që përshkrimi në faqen e internetit trajton, dhe nuk është në kundërshtim me, përshkrimin e përgjegjësi ve të audituesit më poshtë.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.<sup>44</sup>
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

<sup>44</sup>Kjo fjali duhet të modifikohet, si të jetë e përshtatshme, në rrethanat kur audituesi gjithashtu ka përgjegjësinë për të lëshuar një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm së bashku me auditimin e pasqyrave financiare.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nganjë komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

### **Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore**

*[Forma dhe përmbajtja e këtij seksioni të raportit të audituesit mund të variojë në varësi të natyrës së përgjegjësive të tjera raportuese të audituesit të përcaktuara nga ligji, rregullat lokale, ose standardet kombëtare të auditimit. Çështjet e trajtuara nga ligji, rregullat, standardet kombëtare të tjera (të cilave i referohemi me “përgjegjësitë e tjera raportuese”) do të trajtohen brenda këtij seksioni, përveç nëse kur përgjegjësitë e tjera raportuese trajtojnë të njëjtat çështje si ato të paraqitura tek përgjegjësitë raportuese sipas SNA-ve, si pjesë e seksionit të Raportit mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare. Raportimi i përgjegjësive të tjera që trajton të njëjtat çështje si ato të kërkuara nga SNA-të mund të kombinohet (d.m.th. të përfshihet në seksionin e Raportit mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare me një nëntitull të përshtatshëm) por duke u siguruar që kur ekziston një diferencë e tillë, formulimi në raportin e audituesit të diferencojë qartë përgjegjësitë e tjera raportuese nga raportimi që kërkohet sipas SNA-ve.]*

*[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]*

*[Adresa e Audituesit]*

*[Data]*

**Ilustrimi 2: Raporti i Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të një Entiteti të Listuar, të Përgatitura në Përputhje me një Kuadër të Paraqitjes së Drejtë**

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të konsoliduara të një entiteti të listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi është auditim i një grupi, një entiteti dhe filialeve të tij (d.m.th. zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- *Kodi i Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël përfshin të gjitha kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin.*
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar ndonjë anomali materiale në këto informacione.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkojnë nga legjislati lokal.

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Shoqërisë Tregtare ABC [ose një Adresë Tjetër e Duhur]

### Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare<sup>45</sup>

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë tregtare ABC, dhe të filialeve të saj (Grupi), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (*ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për*), pozicionin financiar të konsoliduar të Grupit me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare të konsoliduar dhe flukset e parasë të konsoliduara për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK)*, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare të konsoliduara në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

---

<sup>45</sup>Nën-titulli “Raporti mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” është i panevojshëm në rrethana kur nën-titulli i dytë “Raporti mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore” nuk është i mundur.

## **Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]**

*[Raportimi në përputhje me kërkesat e raportimit në SNA 720 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në Shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar).]*

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara<sup>46</sup>**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të<sup>47</sup>, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe që të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Paragrafi 41(b) i këtij SNA-je shpjegon se materiali i hijëzuar më poshtë mund të vendoset në një Shtojcë të raportit të audituesit. Paragrafi 41(c) shpjegon se referenca mund të bëhet tek faqja e internetit e autoritetit të përshtatshëm e cila përmban përgjegjësitë e audituesit, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht, në vend që ta përfshijmë këtë material në raportin e audituesit,

<sup>46</sup>Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

<sup>47</sup>Kur përgjegjësia e drejtimit është të përgatitë pasqyra financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, kjo mund të lexohet: “Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për të tilla ...”

duke u siguruar që përshkrimi në faqen e internetit trajton, dhe nuk është në kundërshtim me, përshkrimin e përgjegjësi ve të audituesit më poshtë.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare të konsoliduara, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionin mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Grupit.<sup>48</sup>
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Grupit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Grupi të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me informacionet financiare të entiteteve ose veprimtarive të bizneseve brenda Grupit, për të shpehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për

<sup>48</sup>Kjo fjali duhet të modifikohet, si të jetë e përshtatshme, në rrethanat kur audituesi gjithashtu ka përgjigjësinë për të lëshuar një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm së bashku me auditimin e pasqyrave financiare.

drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e auditimit të Grupit. Ne mbetemi të vetmit përgjegjes për opinionin e auditimit.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

## Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore

*[Forma dhe përmbajtja e këtij seksioni të raportit të audituesit mund të variojë në varësi të natyrës së përgjegjësive të tjera raportuese të audituesit të përcaktuara nga ligji, rregullat lokale, ose standardet kombëtare të auditimit. Çështjet e trajtuara nga ligji, rregullat, standardet kombëtare të tjera (të cilave i referohemi me “përgjegjësitë e tjera raportuese”) do të trajtohen brenda këtij seksioni, përveç nëse kur përgjegjësitë e tjera raportuese trajtojnë të njëjtat çështje si ato të paraqitura tek përgjegjësitë raportuese sipas SNA-ve, si pjesë e seksionit të Raportit mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara. Raportimi i përgjegjësive të tjera që trajton të njëjtat çështje si ato të kërkuara nga SNA-të mund të kombinohet (d.m.th. të përfshihet në seksionin e Raportit mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara me një nëntitull të përshtatshëm) por duke u siguruar që kur ekziston një diferencë e tillë, formulimi në raportin e audituesit të diferencojë qartë përgjegjësitë e tjera raportuese nga raportimi që kërkohet sipas SNA-ve.]*

*[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]*

*[Adresa e Audituesit]*

*[Data]*



**Ilustrimi 3: Raporti i Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të një Entiteti të Pa listuar, të Përgatitura në Përputhje me një Kuadër të Paraqitjes së Drejtë**

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Audituesit nuk i kërkohet, dhe ai nuk ka vendosur përndryshe, të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka indentifikuar ndonjë anomali materiale në këto informacione.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat të kërkohen nga legjislacioni lokal.
- Audituesi zgjedh t’i referohet përshkrimit të përgjegjësisë së audituesit të paraqitur në faqen zyrtare të internetit të autoritetit të përshtatshëm.

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Shoqërisë Tregtare ABC [ose një Adresë Tjetër e Duhur]

**Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, *(ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për)*, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në *[juridiksionin]*, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]**

*[Raportimi në përputhje me kërkesat e raportimit në SNA 720 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në Shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar).]*

**Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare<sup>49</sup>**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të<sup>50</sup>, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të

<sup>49</sup>Gjatë gjithë këtyre raporteve ilustruese të audituesit, termat drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen mund të jetë e nevojshme të zevendësohen nga terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfaqëson opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësisë të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në faqen e internetit të (Organizatës) në: [linku i faqes së internetit]. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

*[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]*

[Adresa e Audituesit]

[Data]

---

<sup>50</sup>Kur përgjegjësia e drejtimit është të përgatitë pasqyra financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, kjo mund të lexohet: “Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për të tilla ...”

**Ilustrimi 4: Raporti i Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të një Entiteti të Pa Listuar, të Përgatitura në Përputhje me një Kuadër të Pajtueshmërisë për Qëllime të Përgjithshme**

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, i cili kërkohet nga ligji ose rregullat. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar (Ligji XYZ) të Juridiksionit X (që është një kuadër i raportimit financiar, përfshirë ligjin ose rregullat, i hartuar për të përmbushur nevojat e zakonshme për informacion financiar të një game të gjerë përdoruesish, por që nuk është një kuadër i paraqitjes së drejtë).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Audituesit nuk i kërkohet, dhe ai nuk ka vendosur përndryshe, të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar ndonjë anomali materiale në këto informacione.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat të kërkohen nga legjislacioni lokal.

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

[Adresa e Duhur]

**Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Ligjin XYZ të Juridiksionit X.

**Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]**

[Raportimi në përputhje me kërkesat e raportimit në SNA 720 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në Shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar).]

**Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare<sup>51</sup>**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin XYZ të Juridiksionit X<sup>52</sup>, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

<sup>51</sup>Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

<sup>52</sup>Kur përgjegjësia e drejtimit është të përgatitë pasqyra financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, kjo mund të lexohet: “Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për të tilla ...”

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk një është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Paragrafi 41(b) i këtij SNA-je shpjegon se materiali i hijëzuar më poshtë mund të vendoset në një Shtojcë të raportit të audituesit. Paragrafi 41(c) shpjegon se referenca mund të bëhet tek faqja e internetit e autoritetit të përshtatshëm e cila përmban përgjegjësitë e audituesit, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht, në vend që ta përfshijmë këtë material në raportin e audituesit, duke u siguruar që përshkrimi në faqen e internetit trajton, dhe nuk është në kundërshtim me, përshkrimin e përgjegjësiave të audituesit më poshtë.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas

rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.<sup>53</sup>

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

*[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]*

*[Adresa e Audituesit]*

*[Data]*

---

<sup>53</sup>Kjo fjali duhet të modifikohet, si të jetë e përshtatshme, në rrethanat kur audituesi gjithashtu ka përgjegjësinë për të lëshuar një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm së bashku me auditimin e pasqyrave financiare.